



AUTORËT

Behxhet Mustafa, Avni Hajdari, Shpresa Sojeva Mustafa

LIBRI I MËSIMDHËNËSIT/ES

BIOLOGJIA 7

Për klasën e shtatë të arsimit të mesëm të ulët





PARATHËNIE

Libri i mësimdhënësit/es “Biologjia 7” është hartuar në bazë të planprogramit mësimor, sipas Kurrikulës së re të aprovuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës. Libri është përgatitur për fushën kurrikulare: Shkencat e natyrës, lëndën: Biologji 7, Shkalla e kurrikulës: III.

Ky libër është pjesë e kompletit të librit të mëimit “Biologjia 7” dhe do t’u shërbejë mësimdhënësve/eve si mjet ndihmës për të zbërthyer përmbajtjen e lëndës, e cila është organizuar sipas koncepteve, temave, njësive mësimore dhe rezultateve të të nxëniet të lëndës (RNL).

Në këtë libër keni modelet për planin vjetor, planet dymujore, ato tremujore, si dhe është dhënë një model i orës së mëimit për secilën njësi mësimore (zhvillim), i cili mund të përdoret për realizimin e orës mësimore. Për çdo njësi mësimore janë të prezantuara rezultatet e të nxëniet të lëndës (RNL), kriteret e suksesit, fjalët kyçe, burimet, lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare, metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve.

Në Librin e mësimdhënësit/es jepen shembuj të ndryshëm të metodologjive që mund të përdoren për ta bërë përmbajtjen e arritshme për nxënësit. Në libër gjeni dhe një test si shembull që ju ndihmon për vlerësimin e nxënësve.

Mirëpo, kjo nuk do të thotë që mësimdhënësit/et nuk mund të përzgjedhin metoda dhe planifikime të tjera për realizimin e njësive mësimore. Ata mund t’i përshtatin metodologjitë, strategjitë dhe teknikat e mësimdhënies, varësisht nga nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me qëllim të arritjes së rezultateve të pritura të të nxëniet për orë mësimore. Ky model i librit të mësimdhënësit/es është bërë duke u konsultuar dhe me mësimdhënësit të biologjisë të shkollës së mesme të ulët dhe të lartë.

Koha mësimore (orë mësimore) për një njësi mbetet në kompetencat e mësimdhënësit/es.

Suksese në mësimdhënie dhe arritje në rezultate të të nxëniet ju dëshirojnë,
Autorët.

PËRMBAJTJA

Temat mësimore të shpërndara gjatë muajve (Planifikimi vjetor).....	9
PLANET DY DHE TREMUJORE.....	10

PERIUDHA I

Planifikimi dymujor: Shtator – Tetor.....	11-13
Planifikimi dymujor: Nëntor – Dhjetor.....	14-16

PERIUDHA II

Planifikimi tremujor: Janar – Shkurt- Mars	17-20
--	-------

PERIUDHA III

Planifikimi tremujor: Prill- Maj-Qershor.....	21-25
---	-------

PJESA E PARË

KREU I

NDËRTIMI I TRUPIT TË NJERIUT

Ndërtimi i trupit të njeriut	26-28
------------------------------------	-------

KREU II

MBROJTJA DHE LËVIZJA

Lëkura - organ me role të shumta	29-31
Çrregullimet e strukturës dhe funksionit të lëkurës	32-33
Sistemi i organeve për mbështetje dhe lëvizje	34-35
Nyjat – pjesë të eshtrave lëvizës	36-37
Sistemi muskolor	37-39

KREU III

METABOLIZMI DHE TRANSPORTI

Sistemi i organeve të tretjes	39-41
Çfarë ndodh me ushqimin në zorrë?	42-43
Çrregullimet në aparatit tretës	43-45
Sistemi i qarkullimit të gjakut	45-47
Përbërja e gjakut dhe funksioni	47-49
Imuniteti dhe alergjia	49-51
Sëmundjet...mungon	
Sistemi i organeve të frymëkëmbimit	52-54

Sëmundjet e rrugëve të frymëmarrjes dhe mushkërive	54-55
Sistemi i organeve të ekskretimit	55-58

KREU IV

KOMUNIKIMI

Sistemi nervor dhe hormonal (endokrin)	59-61
Sistemi nervor qendror	61-62
Palca kurrizore dhe lëvizjet refleksive	63-64
Sistemi nervor autonom (vegjetativ)	64-66
Dëmtimet dhe sëmundjet e sistemit nervor me pasoja të mëdha për shëndetin	66-68
Sistemi hormonal-endokrin.....	68-69
Sistemi i organeve ndijore (shqisore)	
Sytë dhe shikimi.....	70-72
Të metat dhe sëmundjet e syrit	73-74
Veshi dhe dëgjimi	75-77
Organet ndijore për aromë, shije dhe prekje	77-79

KREU V

SISTEMI I ORGANEVE TË RIPRODHIMIT TE NJERIU

Sistemi i organeve të riprodhimit te njeriu	80-81
Nga pllenimi deri te lindja	82-84

PJESA E DYTË

SHËNDETI, SJELLJET DHE EMOCIONET E NJERIUT

Ndryshimet në pubertetet dhe ndikimet e të tjerëve në shëndetin e tyre	84-86
Përgjegjësitë prindërore dhe planifikimi familjar	86-88
Sëmundjet që barten përmes kontaktit seksual	89-90
Të drejtat seksuale, ligjet dhe rregulloret	91-92

PJESA E TRETË

Riprodhimi te shtazët	93-94
Riprodhimi te shpendët dhe gjitarët	95-96

PJESA E KATËRT

RIPRODHIMI I BIMËVE

Riprodhimi joseksual i bimëve	97-99
Lulet i japin farat dhe frutat	100-102
Riprodhimi joseksual i bimëve	102-103

TEST VLERËSUES.....104-106

PLANI VJETOR

TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE (PLANI VJETOR)

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: Shkalla III	Klasa: 7
---	---------------------------	---	--------------------

Koncepti: Bota e gjallë			
PERIUDHA (I)		PERIUDHA (II)	PERIUDHA (III)
Shtator-Tetor	Nëntor-Dhjetor	Janar-Shkurt -Mars	Prill-Maj-Qershor
Sistemi i organeve të njeriut	Sistemi i organeve të njeriut	Sistemi i organeve të njeriut Shumimi te njeriu	Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut Shumimi te shtazët Shumimi te bimët
Kontributi në rezultatet e të nxënimit për kompetencat kryesore të shkollës III, klasa e VII			
I-Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv 1,2,3,4,6;			
II-Kompetenca e të menduarit –Mendimtar kreativ 1,6,7,8			
III-Kompetenca e të nxënimit – Nxënës i suksesshëm 1,3,4,5,8;			
IV-Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv 2,7,8			
V-Kompetenca personale – Individ i shëndoshë 2,3,6,,8,9,10;			
VI-Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm 1,2,7;			

PLANET DY DHE TREMUJORE

Periudha e I

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: Shkalla III	Klasa: 7
---	---------------------------	---	--------------------

PLANI DYMUJOR: Shtator – Tetor

Tema-t mësimore : Sistemet e organeve të njeriut

RNK- Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen

I-1. Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.

2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.

3. Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.

4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit

6. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

II- 1. Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në medie.

III.1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.

3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

4. Shfrytëzon dosjen personale për identifikimin e përparësive dhe mangësive në funksion të vetëvlerësimit të përparimit dhe përmirësimit të suksesit në fushën e caktuar.

5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

IV-7. Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

8. Merr pjesë si anëtar i një jurie (në nivel klase apo shkolle) për vlerësimin e një aktiviteti/konkursi sportiv, shkencor, artistik etj., duke u bazuar

në kriteret e paracaktuara.

V-2. Vlerëson përmbajtjen e vlerave pozitive dhe negative të paktën të tri llojeve të ushqimeve të cilat konsumohen në mjedisin e tij ose në rrethinë.

3. Diskuton në grup moshatarësh, duke ofruar argumente, për rëndësinë që ka respektimi i regjimit ditor dhe i aktiviteteve fizike për shëndetin dhe për jetën e njeriut.

RNF- Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut

Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.

Tema-t mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore RNL	Njësitë Mësimore	Koha mësimore	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrik	Burimet
Sistemet e organeve të njeriut	<p>Definon termat: qelizë, ind, organ dhe sistem i organeve.</p> <p>- Përshkruan ndërtimin, rolin dhe rëndësinë e lëkurës.</p> <p>- Identifikon prodhimet e lëkurës.</p> <p>- Hulumton llojet e lëndimeve të lëkurës dhe masat mbrojtëse.</p>	<p>Ndërtimi i trupit të njeriut</p> <p>Lëkura- organ me role të shumta</p> <p>Çrregullimet e strukturës dhe funksionit të lëkurës</p>	17	<p>Mësimdhënie dhe të nxënit që nxit hulumtimin e pavarur;</p> <p>Mësimdhënie e drejtëpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembuj);</p>	<p>Vlerësim për nxënie (informata kthyesë, vlerësim i ndersjelltë)</p> <p>Vlerësimi i punës praktike/eksperimentale</p>	<p>Gjuhë dhe komunikim</p> <p>Ekologji dhe mjedis</p> <p>Gjeografi</p> <p>TIK</p> <p>Ed.Qytetare</p> <p>Matematikë</p> <p>Art Figurativ</p> <p>Histori</p>	

<p>Sistemet e organeve të njeriut</p>	<p>- Hulumton dhe përshkruan ndërtimin dhe funksionin e sistemit skeletor.</p> <p>Identifikon, lëndimet si dhe masat mbrojtëse të e sistemit për levizje.</p> <p>Hulumton dhe përshkruan ndërtimin dhe funksionin e sistemit muskolor.</p> <p>-Përshkruan procesin dhe rrugën e tretjes së ushqimit te njeriu.</p> <p>-Vlerëson rolin e organeve të veçanta në procesin e tretjes.</p> <p>- Vlerëson rëndësinë e mbrojtjes së sistemit të organeve të tretjes.</p> <p>-Hulumton dhe përshkruan ndërtimin dhe funksionin e sistemit të qarkullimit të gjakut. Analizon ndërtimin dhe punën e zemrës.</p> <p>-</p>	<p>Sistemi i organeve për mbështetje dhe lëvizje- sistemi skeletor</p> <p>Nyjat - pjesë të eshtrave lëvizës</p> <p>Sistemi muskolor</p> <p>Sistemi i organeve të tretjes</p> <p>Çfarë ndodh me ushqimin në zorrë?</p> <p>Çrregullimet në aparatit tretës</p> <p>Sistemi i qarkullimit të gjakut</p>		<p>Mësimdhënie me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve. Mësimdhënie indirekte (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve).</p> <p>Mësimdhënie përmes projekteve, punëve kërkimore.</p> <p>Diskutimi dhe të nxënit në bashkëpunim (Në grupe të vogla dhe të mëdha dhe me të gjithë nxënësit).</p> <p>Mësimdhënie dhe të nxënit përmes mjeteve multimediale.</p> <p>Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve.</p>	<p>Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime).</p> <p>Vlerësim për ecurinë dhe produktin e punës me projekte. Vlerësimi individual dhe grupor gjatë punës kërkimore.</p> <p>Vlerësimi me shkrim i cili realizohet përmes teknikave të ndryshme (testeve, kuizeve, eseve, raportet e punës). Vlerësimi i detyrave të shtëpisë.</p>		
--	--	---	--	---	--	--	--

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: Shkalla III	Klasa: 7
---	---------------------------	---	--------------------

PLANI DYMUJOR: Nëntor-Dhjetor

Tema-t mësimore : Sistemet e organeve të njeriut

RNK- Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen

- I-2.** Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
- 6.** Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.
- II- 1.** Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/ problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në medie.
- III-1.** Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
- 3.** Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
- 4.** Shfrytëzon dosjen personale për identifikimin e përparësive dhe mangësive në funksion të vetëvlerësimit të përparimit dhe përmirësimit të suksesit në fushën e caktuar
- 5.** Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.
- 8.** Menaxhon emocionet dhe ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve, mjetet që ka gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti, veprë arti (në klasë/shkollë apo gjetiu).
- IV-8.** Merr pjesë si anëtar i një jurie (në nivel klase apo shkolle) për vlerësimin e një aktiviteti/konkursi sportiv, shkencor, artistik etj., duke u bazuar në kriteret e paracaktuara.
- V- 8.** Shpjegon, gjatë një debati, prezantimi, me gojë ose me shkrim, pasojat e përdorimit të duhanit, alkoolit, drogës dhe substancave të tjera të dëmshme për shëndetin dhe mirëqenien e individit
- 10.** Merr pjesë ose udhëheq një grup punues që bashkëpunon me përfaqësues të komunitetit për të ndihmuar moshatarët dhe anëtarët e tjerë të komunitetit që kanë probleme shëndetësore, sociale, ekonomike etj., raporton më pas me gojë ose me shkrim për përvojat personale të fituara.

RNF- Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërin e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut

Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.

Tema-t mësimore	Rezultatet e të nxëniet për tema mësimore RNL	Njësitë Mësimore	Koha mësimore	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët tjera mësimore, me çështjet e tjera	Burimet
Sistemet e organeve të njeriut	<p>Hulumton përbërjen, rolin dhe rëndësinë e përbërësve të gjakut dhe limfës.</p> <p>Sqaron konceptet: imunitet, alergji dhe identifikon grupet e gjakut.</p> <p>Emërton rrugët e frymëmarrjes, përshkruan ndërtimin dhe funksionin e tyre</p> <p>Përshkruan mekanizmat e frymëmarrjes mushkërore dhe rregullimin e saj.</p> <p>Vlerëson rolin dhe domosdoshmërin e ruajtjes së organeve të frymëmarrjes si dhe faktorët që demtojnë organet e frymëmarrjes.</p>	<p>Përbërja e gjakut dhe funksioni</p> <p>Imuniteti dhe alergjia</p> <p>Sistemi i organeve të frymëkëmbimit</p> <p>Sëmundjet e rrugëve të frymëmarrjes dhe mushkërive.</p>		<p>Mësimdhënie dhe të nxëniet që nxit hulumtimin e pavarur.</p> <p>Mësimdhënie e drejtëpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembuj.</p> <p>Mësimdhënie me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve.</p> <p>Mësimdhënie indirekte (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve.</p>	<p>Vlerësim për nxënie (informata kthyesë, vlerësim i ndersjellët).</p> <p>Vlerësimi i punës praktike/eksperimentale.</p> <p>Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime).</p>	<p>Gjuhë dhe komunikim</p> <p>Ekologji dhe mjedis</p> <p>Gjeografi</p> <p>TIK</p> <p>Ed.Qytetare</p> <p>Matematikë</p> <p>Art Figurativ</p> <p>Histori</p>	

<p>Sistemet e organeve të njeriut</p>	<p>Definon termin tajitje dhe emërton organet kryesore për tajitje te njeriu. Analizon krijimin e urinës. Hulumton mundësitë e ruajtjes së sistemit të ekskretimit.</p>	<p>Sistemi i organeve të ekskretimit.</p>		<p>Mësimdhënie përmes projekteve, punëve kërkimore.</p> <p>Diskutimi dhe të nxënit në bashkëpunim(Në grupe të vogla dhe të mëdha dhe me të gjithë nxënësit) mdhënie dhe të nxënit përmes mjeteve multimediale.</p> <p>Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve.</p>	<p>Vlerësim për ecurinë dhe produktin e punës me projekte. Vlerësimi individual dhe grupor gjatë punës kërkimor. Vlerësimi me shkrim i cili realizohet përmes teknikave të ndryshme (testeve, kuizeve, eseve, raportet e punës). Vlerësimi i detyrave të shtëpisë.</p>		
--	---	---	--	--	--	--	--

Periudha e II

NJËSITË MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE (PLANI TREMUJOR)

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: Shkalla III	Klasa: 7
---	---------------------------	---	--------------------

PLANI TREMUJOR: JANAR-SHKURT-MARS

Tema-t mësimore : Sistemet e organeve të njeriut; Shumimi te njeriu

RNK- Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen

- I-2.** Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
- 3.** Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.
- 4.** Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.
- 6.** Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.
- II- 6.** Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.
- 7.** Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.
- III-1.** Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
- 3.** Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
- 5.** Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.
- 8.** Menaxhon emocionet dhe ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve, mjetet që ka gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti, veprë arti (në klasë/shkollë apo gjetiu).
- IV-7.** Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

V- 10- Merr pjesë ose udhëheq një grup punues që bashkëpunon me përfaqësues të komunitetit për të ndihmuar moshatarët dhe anëtarët e tjerë të komunitetit që kanë probleme shëndetësore, sociale, ekonomike etj., raporton më pas me gojë ose me shkrim për përvojat personale të fituara

RNF- Rezultatet e të nxënimit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërin e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.

Tema-t mësimore	Rezultatet e të nxënimit për tema mësimore RNL	Njësitë Mësimore	Koha mësimore	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare	Burimet
-----------------	--	------------------	---------------	-----------------------------	---------------------------	---	---------

<p>Sistemet e organeve të njeriut</p>	<p>Hulumton ndërtimin dhe funksionimin e sistemit nervor.</p>	<p>Sistemi nervor dhe hormonal (endokrin).</p>		<p>Mësimdhënie dhe të nxënit që nxit hulumtimin e pavarur.</p>	<p>Vlerësim për nxënie (informate kthyesë, vlerësim i ndersjelltë).</p>	<p>Gjuhë dhe komunikim Ekologji dhe mjedis Gjeografi TIK Ed.Qytetare Matematikë Art Figurativ Histori</p>	
<p>Shumimi te njeriu</p>	<p>Analizon ndervatësin e pjesëve të sistemit nervor.</p> <p>Analizon harkun refleksiv.</p> <p>Hulumton ndërtimin dhe funksionimin e sistemit nervor.</p> <p>Analizon mundësi për kujdesin ndaj sistemit nervor dhe pasojat në rast dëmtimi.</p> <p>Emërton gjëndrat me tajitje të brendshme te njeriu dhe përshkruan pozitën e tyre në trup. Përshkruan si gjëndrat endokrine kontrollojnë organe e funksione të caktuara nëpërmjet hormoneve.</p>	<p>Sistemi nervor qendror - truri dhe palca kurrizore.</p> <p>Palca kurrizore dhe lëvizjet refleksive</p> <p>Sistemi nervor autonom (vegjetativ).</p> <p>Dëmtimet dhe sëmundjet e sistemit nervor me pasoja të mëdha për shëndetin</p> <p>Sistemi hormonal – endokrin.</p>		<p>Mësimdhënie e drejtëpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembuj. Mësimdhënie me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve. Mësimdhënie indirekte (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve.</p>	<p>Vlerësimi i punës praktike/eksperimentale.</p> <p>Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime).</p>		

<p>Sistemet e organeve të njeriut</p>	<p>Emërton dhe përshkruan organet shqisore në trupin tonë (shqisës së të parit, dëgjuarit, ekuilibrit, shijes, nuhatjes, shqisave lëkurore) si dhe analizon funksionin e tyre.</p> <p>Identifikon dëmtimet dhe masat mbrojtëse të shqisave.</p> <p>Emërton dhe përshkruan organet shqisore në trupin tonë (shqisës së të parit, dëgjuarit, ekuilibrit, shijes, nuhatjes, shqisave lëkurore) si dhe analizon funksionin e tyre.</p> <p>Përshkruan ndërtimin dhe funksionin e gjëndrave seksuale te njeriu. Tregon se sistemi riprodhues seksual, lehtëson procesin e trashëgimisë (bartjen e informatave gjetetike ose tipareve gjenetike nga një gjeneratë në tjetrën). Përshkruan shkurtimisht strukturat e sistemeve - riprodhuese te individit femër dhe mashkull si dhe funksionin e tyre në frytëzim.</p>	<p>Sistemi i organeve ndijore (shqisore) sytë dhe shikimi.</p> <p>Të metat dhe sëmundjet e syrit.</p> <p>Veshi dhe dëgjimi, sëmundjet e veshit. Organet ndijore për aromë, shije dhe prekje.</p> <p>Sistemi i organeve të riprodhimit te njeriu.</p> <p>Nga pllenimi deri te lindja.</p>		<p>Mësimdhënie përmes projekteve, punëve kërkimore.</p> <p>Diskutimi dhe të nxënit në bashkëpunim(Në grupe të vogla dhe të mëdha dhe me të gjithë nxënësit) mdhënie dhe të nxënit përmes mjeteve multimediale.</p> <p>Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve.</p>	<p>Vlerësim për ecurinë dhe produktin e punës me projekte.</p> <p>Vlerësimi individual dhe grupor gjatë punës kërkimor.</p> <p>Vlerësimi me shkrim i cili realizohet përmes teknikave të ndryshme (testeve, kuizeve, eseve, raportet e punës).</p> <p>Vlerësimi i detyrave të shtëpisë.</p>		
--	--	--	--	--	---	--	--

Periudha e III

NJËSITË MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE (PLANI TREMUJOR)

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: Shkalla III	Klasa: 7
---	---------------------------	---	--------------------

PLANI TREMUJOR: PRILL-MAJ-QERSHOR

Tema-t mësimore : Shendeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut; Shumimi te shtazët; Shumimi te bimët

RNK- Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen

I-2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.

3. Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.

4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.

6. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

II- 7. Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.

8. Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike

III-1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.

3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

IV-4. Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p.sh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet.

7. Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të

përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

V- 6. Vlerëson shkaqet e një situatë të mundshme të konfliktit midis moshatarëve ose midis anëtarëve të grupit dhe propozon alternativa për parandalimin e rrezikut dhe zgjidhjen më të mirë për ta, duke ndarë përvojat dhe mendimet për kohezionin e grupit

9. Përshkruan ndryshimet fizike, psikike dhe emocionale të fazës së pubertetit duke paraqitur fakte për ndikimin e tyre në mënyrën (stilin) e jetesës.

VI- 7. Identifikon paragjykimet që mund të ekzistojnë në shkollë dhe në rrethinë si dhe propozon veprime konkrete për luftimin e tyre.

RNF- Rezultatet e të nxënës të fushës kurrikulare të shkollës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut

Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.

Tema-t mësimore	Rezultatet e të nxënës për tema mësimore RNL	Njësitë Mësimore	Koha mësimore	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet e...-it	Burimet
-----------------	--	------------------	---------------	-----------------------------	---------------------------	---	---------

<p>Shendeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut</p>	<p>Përshkuan ndryshimet e trupit gjatë rritjes, zhvillimit dhe ndikimin e reflektimeve të të tjerëve për shëndetin e tyre.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Identifikon shërbimet ku adoleshentët mund të shkojnë për ndihmë. - Identifikon përgjegjësitë e prindësisë se hershme, rritjes së fëmijëve, planifikimit familjar, planifikimi në karrierë, kontracepsionin, vendimmarrjen dhe kujdesin në rast të shtatzënisë. - Përshkruan sjelljet e rrezikshme, simptomat përcjelljen dhe parandalimin e STS dhe HIV. - Shpjegon të drejtat seksuale për vete, të tjerët ligjet dhe rregulloret. - Vlerëson ndikimin e moshës, gjinisë, religjionit dhe kulturës në marrëdhënie me të tjerët. 	<p>Ndryshimet në pubertetet dhe ndikimet e të tjerëve në shëndetin e tyre.</p> <p>Përgjegjësitë prindore dhe planifikimi familjar.</p> <p>Sëmundjet që barten përmes kontaktit seksual.</p> <p>Të drejtat seksuale, ligjet dhe rregulloret.</p>		<p>Mësimdhënie dhe të nxëniet që nxit hulumtimin e pavarur.</p> <p>Mësimdhënie e drejtëpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembuj. Mësimdhënie me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve. Mësimdhënie indirekte (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve.</p>	<p>Vlerësim për nxënie (informate kthyesë, vlerësim i ndersjelltë).</p> <p>Vlerësimi i punës praktike/eksperimentale.</p> <p>Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime).</p>	<p>Gjuhë dhe komunikim Ekologji dhe mjedis Gjeografi TIK Ed.Qytetare Matematikë Art Figurativ Histori</p>	
--	--	---	--	--	--	---	--

<p>Shumimi te shtazët</p>	<p>- Zbaton fjalët dhe përkufizimet kryesore në procesin e një cikli jetësor. - Hulumton dhe përshkruan format e shumimit te shtazët. - Hulumton dhe përshkruan ngjashmëritë dhe dallimet gjatë procesit të shumimit tek organizmat e ndryshëm. Hulumton fazat kryesore të zhvillimit embrional tek ujëtokësorët (në shembullin e bretkosës) dhe te shpendët (në shembullin e zogut të pulës). - Vlerëson rolin e shumimit të shtazëve në zhvillimin e botës së gjallë.</p>	<p>Riprodhimi te shtazët</p> <p>Riprodhimi te shpendët dhe gjitarët</p>		<p>Mësimdhënie përmes projekteve, punëve kërkimore.</p> <p>Diskutimi dhe të nxëniti në bashkëpunim(Në grupe të vogla dhe të mëdha dhe me të gjithë nxënësit) mdhënie dhe të nxëniti përmes mjeteve multimediale.</p> <p>Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve.</p>	<p>Vlerësim për ecurinë dhe produktin e punës me projekte. Vlerësimi individual dhe grupor gjatë punës kërkimor. Vlerësimi me shkrim i cili realizohet përmes teknikave të ndryshme (testeve, kuizeve, eseve, raportet e punës). Vlerësimi i detyrave të shtëpisë.</p>		
<p>Shumimi te bimët</p>	<p>- Hulumton dhe përshkruan format e shumimit te bimët. - Hulumton dhe të përshkruan ngjashmëritë dhe dallimet gjatë procesit të shumimit tek grupet bimore. - Vlerëson rolin e shumimit të bimëve në zhvillimin e botës së gjallë.</p>	<p>Riprodhimi seksual i bimëve</p> <p>Lulet i japin farat dhe frutat</p> <p>Riprodhimi joseksual i bimëve.</p>					



Periudha e I

Shtator- Tetor

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: III Klasa: VII

Tema (nga– plani dymujor):

Sistemi i organeve të njeriut

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

Definon termat: qelizë, ind, organ dhe sistem i organeve.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I-2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.

I-6. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë

IV-7. Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Ndërtimi i trupit të njeriut**

Fjalët kyçe: *qeliza shtazore, indi lidhor ,epithelial, zemra, veshkët*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Shpjegon termat qelizë, ind, organ dhe sistemi i organeve

Identifikon tipet e qelizave të trupit të njeriut

Përshkruan llojet e indeve që e ndërtojnë trupin e njeriut

Kriteret e suksesit:

Dallo nga fotografia të paktën 4 lloje të qelizave, 2 lloje të indeve dhe 2 organe

Numëro veçoritë e indeve kryesore

Përshkruaj hierarkinë e organizimit të organizmit

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Modele të qelizës shtazore, fotografi nga internet dhe libri Biologjia 7.

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fizikë, Gjeografi, Gjuhë dhe komunikim

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

LINK (rendit, grupo, shëno)

Mësimdhënësi/ja shkruan në tabelë konceptin “qelizë” dhe nxit nxënësit të shkruajnë sa më shumë togfjalësia në lidhje me të nga njohuritë që ata kanë mbi qelizën. Mësimdhënësi/ja i lë nxënësit për 3-4 minuta në dyshe që të renditin në letër lidhjet ose marrëdhëniet e qelizës në organizëm.

Disa nga emërtimet e qelizës mund të jenë: njësia funksionale; njësia më e vogël ndërtimore; përbëjnë nivelin e parë të organizmit; qelizat të gjakut, qeliza muskulore etj. Nxënësit përgjigjen lirshëm për ato që dinë për qelizën. Mësimdhënësi/ja i rendit këto emërtime në tabelë dhe më pas kërkon shpjegime nga nxënësit për këto emërtime.


HARTA E KONCEPTIT



Mësimdhënësi/ja paraqet hartën e konceptit në formën e tabelës, dhe kërkon nga nxënësit të lexojnë tekstin dhe i vë nxënësit të punojnë në dyshe, duke plotësuar një tabelë si ajo e paraqitur në klasë.

Koncepti	Shpjegimi
Qelizë nervore	
Qelizë muskulore	
Qelizë eshtërore	
Qelizë kërcore	
Qelizë epiteliale	
Qelizë sekretuese	
Qelizë yndyrore	
Qeliza të gjakut	
Qeliza seksuale	
Ind epitelial	
Ind muskolor	
Ind nervor	
Ind lidhor	
Organe	
Sisteme të organeve	


DISKUTIM

*Dhe në pjesën përfundimtare mësimdhënësi/ja fton nxënësit që të marrin pjesë në diskutimin e hapur për të gjithë klasën, kërkon nga nxënësit që bazuar në fotografinë e shfaqur në ekran të japin shpjegimin përkatës. (foto shfaqen qelizat e ndryshme, kërkohet që ata ti dallojnë nga fotografia dhe të bëjnë një përshkrim të shkurtër të asaj qfarë mësuan).





Indi lidhor, epitelial, muskolor, nervor



(Shtoni edhe fotografi të tjera)

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informata kthyesë, vlerësim i ndersjellë)

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Krijojnë një model tredimensional të ndonjë prej qelizave trupore. Për modelim sugjeroju materiale të tilla, si xhelatinë për citoplazmë, masë plastike ose qese për membranën qelizore dhe objekte të ndryshme të vogla, të tilla si mermer apo guralecë për bërthamëndhe organelet e tjera

REFLEKTIMI PËR ORË MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: III Klasa: VII

Tema (nga– plani dymujor):

Sistemi i organeve të njeriut

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

Përshkruan ndërtimin, rolin dhe rëndësinë e lëkurës. Identifikon prodhimet e lëkurës.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I-6. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

III-3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

III-5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprahe që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Lëkura- organ me role të shumta**

Fjalët kyçe: *Lëkura, dermatoglife, epiderma, derma, hipoderma, thonjtë, qimet, melanina, gjëndrat dhjamore.*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Shpjegon ndërtimin e lëkurës; -

Numëron prodhimet e lëkurës;

Vlerëson rolin e lëkurës dhe kujdesin ndaj saj

Kriteret e suksesit:

Emërto shtresat e lëkurës

Listo disa prodhime të lëkurës duke i lokalizuar në trupin tënd

Numëro rolet e lëkurës

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri “Biologjia 7“, fotografi,



Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Tik, Kimi,

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

IMAGJINATË E DREJTUAR

Gjatë kësaj faze mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve të shikojnë në ekran disa fotografi, pastaj u kërkon nxënësve që të mendojnë për pak kohë rreth imazheve që kanë parë, pastaj i fton ata të fillojnë diskutimin.




VEPRIMTARI ME LEXIM TË DREJTUAR (VLD)

Mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve të lexojnë temën me pjesë. Ndërkohë, në dërrasë vizaton një tabelë përmbledhëse, të cilën u kërkon ta plotësojnë së bashku në grup.

<i>Koncepti</i>	<i>Sqarimet</i>
<i>Ndërtimi i lëkurës</i>	
<i>Funksionet e lëkurës</i>	
<i>Prodhimet e lëkurës</i>	

KLLASTER

Mësimdhënësi-ja ndan klasën në grupe pune dhe në tabelë modelon një kllaster, me në qendër konceptin “Lëkura”. Më pas u shpjegon nxënësve se si duhet t’i sistemojnë njohuritë e tyre mbi lëkurën për të plotësuar kllasterin, i udhëzon nxënësit se si ata mund të përdorin sqarimet e tyre të gjetura më parë për të kompletuar sa më mirë kllasterin.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informate kthyesë, vlerësim i ndersjelltë)

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësve u kërkohet të hulumtojnë në internet apo ndonjë material tjetër (si enciklopedi etj.) rreth ndërtimit dhe çrregullimeve të lëkurës. Hulumtimin ta paraqesin në formë eseje me rreth 200 fjalë.

REFLEKTIMI PËR ORË MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: III Klasa: VII

Tema (nga– plani dymujor):

Sistemi i organeve të njeriut

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

Hulumton llojet e lëndimeve të lëkurës dhe masat mbrojtëse.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I-6. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

I-4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.

III-5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërin e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Çrregullimet e strukturës dhe funksionit të lëkurës**

Fjalët kyçe: *lëndime, psoriasis, ekzema, zgjeba, djegia nga dielli.*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Liston disa nga ç'rregullimet e lëkures

Numëron lëndimet e lëkurës;

Përmend disa nga masat mbrojtëse të lëkurës

Kriteret e suksesit:

Identifiko të paktën 4 çrregullime të lëkurës

Jep të paktën 2 shembuj të lëndimeve të lëkurës

Shpjego mbrojtjen natyrale dhe artificiale të lëkurës nga rrezatimi diellor

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri "Biologjia 7", fotografi,

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Tik, Kimi,

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

IMAGJINATË E DREJTUAR

Gjatë kësaj faze mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve të shikojnë në ekran disa fotografi të lëndimeve, çrregullimeve të lëkurës, mirëpo nuk ju jep sqarime se për çfarë po bëhet fjalë. Pastaj fton nxënësit të përcjellin me vëmendje fotografitë dhe më pas të reflektojnë mbi ato që shikuan. Bazuar në informacionet që nxënësit tani kanë nga ora e kaluar për lëkurën dhe ndërtimin e saj si dhe rëndësinë e saj presim nga ta që të bëjnë ndërlidhje logjike dhe të reflektojnë në mënyrë të suksesshme. (Bëjë kujdes në përzgjedhje të nxënësve që nuk janë shumë aktiv në mënyrë që të marrin pjesë aktive në mësimnxënie).



DITARI DYPJESËSH

Pasi nxënësit të reflektojnë mbi atë që shikuan bashkarisht arrijnë të zbulojnë se për çfarë do të mësojnë sot, pra lëndimet dhe kujdesi për lëkurën. Pastaj mësimdhënësi-ja jep disa sqarime të shkurtra lidhur me temën, për dallimin në mes të lëndimeve të lëkurës dhe sëmundjeve të saj, si dhe kujdesin që duhet të bëjmë për të ruajtur një organ kaq të rëndësishëm siç është lëkura. Në vazhdim udhëzon nxënësit që të hapin librat faqe 21 dhe të fillojnë të lexojnë informacionet nga libri ndërkohë pas leximit në heshtje i udhëzon ata që të punojnë një ditarë dypjesësh me konceptet e reja dhe sqarimet përkatëse.

Pastaj përzgjedh në mënyrë rastësore nga secili grup nga një përfaqësues që po të njejten tabelë ta plotësojnë dhe që më pas do ta komentojnë së bashku.

Përafërsishtë kështu.

Konceptete –Sëmundjet/ ç'rregullimet	Sqarimi
Shenjat e lindura	
Aknet	
Zgjedhja	
Lythat	
Ekzema	
Psoriaza	
Djegia e lëkurës	
Djegia e shkalles së parë	
Djegia e shkalles së dytë	
Djegia e shkalles së tretë	
Mbrojtja natyrale dhe artificiale e lëkurës nga dielli	

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime)

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIMI PËR ORË MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: III Klasa: VII

Tema (nga– plani dymujor):

Sistemi i organeve të njeriut

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

Hulumton dhe përshkruan ndërtimin dhe funksionin e sistemit skeletor.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I-4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.

II-1. Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/ problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në medie.

IV-7. Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Sistemi i organeve për mbështetje dhe lëvizje**

Fjalët kyçe: *skelet, ashtror, kërcor, periost, elasticitet, osein, sutura.*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Shpjegon ndërtimin e skeletit të njeriut

Tregon funksionet e skeletit të njeriut

Interpreton përmes modelit të skeletit ndërtimin e trungut skeletor

Kriteret e suksesit:

Specifiko eshtrat e kafkës, trungut, gjymtyrëve të njeriut

Defino si e mbajmë trupin drejtë

Dallo funksionin e kafazit të krahorit


Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri “Biologjia 7”, fotografi, laptopi, tv, model skelti, hamer skeleti

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Tik, Kimi,

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE



IMAGJINATË E DREJTUAR

Këtë fazë të orës mësimore mësimdhënësi/ja e fillon duke u vënë përpara nxënësve modelin e skeletit, fillimisht i pyet ata se si është e mundur që të qëndrojnë në këmbë vertikalisht, si është e mundur që edhe pas aktiviteteve si gjimnastike, not etj., që ktheheni në gjendje të rregullt vertikale pa ndonjë pengesë? Pasi merr disa përgjigje të nxënësve i fton ata të shikojnë një video informuese për ndërtimin e skeletit.

<https://www.youtube.com/watch?v=-HHE6y7ceJE>

LEKSION I AVANSUAR

Pasi nxënësit kanë shikuar videon dhe kanë diskutuar për të në pika të shkurta, mësimdhënësi-ja fillon tu sqaroj ndërtimin e skletit, gjatë dhënies së sqarimeve përkatëse përdorë posterin (hamer) ndërtimin e skeletit--model ndërkohë në grupe janë të shpërndara modele të eshtrave dhe të komplet sistemit skeletor.Pastaj i fton nxënësit që të hapin librat dhe të lexojnë njësinë mësimore nga libri.

KLLASTER

Mësimdhënësi-ja ndan klasën në grupe pune dhe në tabelë modelon një kllaster, me në qendër konceptin "SKELETI". Më pas u shpjegon nxënësve se si duhet t'i sistemojnë njohuritë e tyre mbi skeletin për të plotësuar kllasterin.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informate kthyesë, vlerësim i ndersjelltë).

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Duke përdorur një shumëllojshmëri të materialeve në dispozicion, ata do të ndërtojnë një model të skeletit njerëzor. Aktivitetet e ndërtimit dhe burimet gjithashtu ofrohen në faqen e internetit.

REFLEKTIMI PËR ORË MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: III Klasa: VII

Tema (nga– plani dymujor):

Sistemi i organeve të njeriut

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

Identifikon, lëndimet si dhe masat mbrojtëse të sistemit për lëvizje.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I-4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.

III-5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

IV-7. Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Nyjat-pjesë të eshtrave lëvizës**

Fjalët kyçe: skelet, ndrydhje, ligament, shtrembim, rakit

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Përshkruan sëmundjet dhe lëndimet e mundshme në eshtrat dhe nyjat

Shpjegon ndërtimin dhe funksionin e nyjave

Kriteret e suksesit:

Listo sëmundjet dhe lëndimet që mund të ndikojnë në eshtrat dhe nyjat

Dallo llojet e ndryshme të nyjave dhe mënyrën se si ato lëvizin

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri “Biologjia 7”,

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Kimi,

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

DI-DUA TË DI- MËSOVA

Njësinë e re mësimore mësimdhënësi-ja e fillon me teknikën “DI, DUA TË DI, MËSOVA”, duke u kërkuar nxënësve të tregojnë çfarë dinë nga njohuritë e mëparshme lidhur me çrregullimet e sistemit të organeve për lëvizje. Këto njohuri nxënësit i shkruajnë në kolonën DI, (ndërkohë pas 2-3 minuta del një nxënës në tabel dhe e plotëson kolonën di me komente të veta dhe të shokëve).

**Pjesën kryesore të orës mësimore mësimdhënësi/ja e realizon përmes kolonës “Dua të di”, nxënësit fillimisht lexojnë njësinë mësimore, shikojnë nëse ka diçka që nuk po e kuptojnë apo nga njohuritë e mëparshme e dinë atë informacion ndryshe. Pasi ta kenë lexuar njësinë mësimore dhe ti kenë marrë shpjegimet e nevojshme*

nxënësit plotësojnë tabelën si më poshtë, duke i shkruar njohuritë në kolonën dua të di, gjithashtu kjo kolonë plotësohet edhe me pyetje rreth njohurive që ata duan të dinë, duke u ndihmuar edhe nga mësimdhënësi/ja.
 *Pjesën e fundit të fazës së orës mësimore e zhvillon duke plotësuar kolonën “Mësova”, nga nxënësit kërkon që të diskutojnë lidhur me njohuritë që i kanë mësuar, duke e plotësuar kështu kolonën e fundit në tabelë. Këtë kolonë e plotësojnë fillimisht secili individualisht dhe pastaj ftohet njëri në tabelë dhe e plotësojmë edhe kolonën e mbetur.

<i>DI</i>	<i>DUA TË DI</i>	<i>MËSOVA</i>

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informate kthyesë, vlerësim i ndersjelltë)

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit të hulumtojnë për sëmundjet dhe lëndimet e eshtrave në internet.

REFLEKTIMI PËR ORË MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: III Klasa:VII

Tema (nga– plani dymujor):

Sistemi i organeve të njeriut

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

Hulumton dhe përshkruan ndërtimin dhe funksionin e sistemit muskolor

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I-2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve

III 3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

III 5. Ndërlidhë temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin

jetësorë të njeriut.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Sistemi muskolor**

Fjalët kyçe *Sistemi muskolor, muskujt skeletorë, muskujt e zemrës, muskujt e lëmuar, dejzit, fibrat e muskujve*

Rezultati/et e të nxënësve për orë mësimore:

Klasifikon muskujt në bazë të ndërtimit dhe funksionit

Përshkruan ndërtimin e muskulit skeletik të dorës së njeriut

Dallon veprimin e muskujve të vullnetshëm dhe të pavullnetshëm

Kriteret e suksesit:

Identifikon muskujt e lëmuar, tërthorovijor dhe të zemrës

Shpjego ndërtimin e ndonjërit nga tipet e muskujve

Trego funksionimin e muskujve të vullnetshëm dhe të pavullnetshëm

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri “Biologjia 7”,

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Kimi,

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

MARRËDHËNIET PYETJE – PËRGJIGJE

Mësimdhënësi/ja: Sistemet e organeve njerëzore punojnë së bashku për të kryer shumë nga funksionet e tyre. Sistemet skeletore dhe muskulore nuk janë përjashtim. Pyetjet: - A e dini se si funksionojnë sistemet skeletore dhe muskulore? - Si mendoni se muskujt janë në gjendje të lëvizin eshtrat? Mësimdhënësi/ja vazhdon me pyetjet: - U kërkon nxënësve të tregojnë çka ndodh me muskujt e krahut të tyre kur të përkulin krahun dhe shtrijnë atë dhe çka ndiejnë? -Të tregojnë çfarë është muskuli i zemrës dhe si punon ai? -Të tregojnë ku gjenden muskujt e lëmuar dhe si punojnë ata? Një mendim i zakonshëm është se muskujt përdoren vetëm për aktivitete fizike vullnetare. Sigurohuni që nxënësit të kuptojnë që muskujt e lëmuar brenda trupit kontrollojnë pavullnetshëm funksionet e rëndësishme të trupit, të tilla si lëvizja e ushqimit nëpërmjet sistemit të tretjes dhe pompimit të zemrës. Gjatë diskutimit vini në dukje se këto kontraktime muskulore janë të nevojshme për jetën në vetvete.

DRTA

Mësimdhënësi/ja udhëzon nxënësit që të lexojnë pjesën e njësiesë “Kujdes nga steroidet anabolike”, për 10 minuta, pastaj parashtroju pyetjet: - Për çfarë qëllimi u prodhuan në fillim steroidet dhe si filluan të keqpërdorën? - Cilat janë efektet anësore serioze të steroideve? I marrim përgjigjet nga nxënësit dhe i shkruajmë në tabelë, pastaj bëjmë debat mes grupeve.

SHKRIM I LIRË

Në pjesën e fundit të orës mësimore nxënësit bëjnë një shkrim të lirë. Titulli i shkrimit mund të jetë: Sa ndikojnë stërvitjet e rregullta, aktivitetet sportive dhe ushqimi i shëndetshëm në zhvillimin e muskulaturës. Nxënësit

udhëzoni të plotësojnë fletoren e punës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informate kthyesë, vlerësim i ndersjelltë)

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hulumton në internet për ndikimin e dëmshëm të steroideve në organizëm.

REFLEKTIMI PËR ORË MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: III Klasa: VII

Tema (nga- plani dymujor):

Sistemi i organeve të njeriut

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

Përshkruan procesin dhe rrugën e tretjes së ushqimit te njeriu

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I-3. Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.

III-5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

IV-7. Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Sistemi i organeve të tretjes**

Fjalët kyçe *tretja, goja, dhëmbët, ezofagu, lukthi, kapërçelli*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Numëron pjesët përbërëse të aparatit tretës te njeriu

Përshkruan ndërtimin bazë të gypit tretës të njeriut

Shpjegon funksionin e lukthit në tretjen e ushqimit

Kriteret e suksesit:

Emërto nga modeli organet që e ndërtojnë sistemin tretës

Trego çfarë ndodhë me ushqimin sapo ai të futet në gojë

Veço funksionin e lukthit duke potencuar rëndësinë e enzimeve

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri “Biologjia 7”, llaptopi, projector, model sistemi tretës

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Kimi, TIK

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

IMAGJINATË E DREJTUAR

Fillimisht mësimdhënësi-ja i udhëzon nxënësit që të përcjellin një video të shkurtë për sistemin digjestiv, pastaj fton disa nga nxënësit (duke ju dhënë përparësinë atyre më pak aktiv, në mënyrë që të bëhen pjesë aktive e mësimnxënies) të komentojnë çfarë kanë parë.

<https://www.youtube.com/watch?v=7u9KP9hNlcl>

DITARI DYPJESËSH

Pasi nxënësit të reflektojnë mbi atë që shikuan bashkarisht arrijnë të zbulojnë se për çfarë do të mësojnë sot, pra sistemin e organeve të tretjes. Pastaj mësimdhënësi-ja jep disa sqarime të shkurtëra lidhur me temën. Në vazhdim udhëzon nxënësit që të hapin librat faqe 40 dhe të fillojnë të lexojnë informacionet nga libri, ndërkohë pas leximit në heshtje i udhëzon ata që të punojnë një ditarë dypjesësh me konceptet e reja dhe sqarimet përkatëse.


Pastaj përzgjedh në mënyrë rastësore nga secili grup nga një përfaqësues që po të njejten tabelë ta plotësojnë edhe në tabelë që më pas do ta komentojnë së bashku. (Shpërndahen fotografi dhe pjesë të modeleve të organeve të tretjes të nxënësit që ti kenë pranë gjatë leximit).

Përafërsishtë kështu.

Konceptet	Sqarimet
Organet që e ndërtojnë aparatit tretës	
Zgavra e gojës	<i>marrja e ushqimit; ka gjëndrat e pështymës, prodhojnë amilazë; dhëmbët dhe dhëmballët copëtojnë dhe përtypin ushqimin; gjuha përzien ushqimin.</i>
Dhëmbët	<i>Grimcimi mekanik i ushqimit</i>
Llojet e dhëmbëve	
Gjuha	
Fyti dhe lukthi	<i>Fyti dhe kapërcelli: Pasi të zbutet ushqimi, kalon në fyt, vendi ku kryqëzohen organet e tretjes me organet e frymëmarrjes-epigglotisi. Tretja e ushqimit; përthithja e ushqimit, “Trastë” muskulore që shërben për ruajtjen e ushqimit për pak kohë.</i>

DISKUTIM

Pastaj ftohen nxënësit që të diskutojnë fillimisht në grup për atë çfarë kanë lexuar dhe më pas të reflektojnë si grup përmes përfaqësuesit të grupit. Ndihmoj duke i orientuar me pyetjet si : përshkruaj rrugën që ndjek ushqimi nga goja deri në vrimën anale?, Numëro organet që e ndërtojnë sistemin e organeve të tretjes?, Çfarë ndodhë me ushqimin në gojë?, etj.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informate kthyses, vlerësim i ndersjelltë)

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Rekomandoni nxënësit të lexojnë literaturë dhe të shfrytëzojnë internetin për më shumë informata lidhur me sistemin e tretjes. Kërkoni nga nxënësit të shkruajnë një përmbledhje nga ajo që kanë hulumtuar dhe t'i lexojnë e komentojnë në klasë.

REFLEKTIMI PËR ORË MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: III Klasa: VII

Tema (nga- plani dymujor):

Sistemi i organeve të njeriut

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

Vlerëson rolin e organeve të veçanta në procesin e tretjes.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I-1. Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkruar, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.

I 4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.

III-4. Shfrytëzon dosjen personale për identifikimin e përparësive dhe mangësive në funksion të vetëvlerësimit të përparimit dhe përmirësimit të suksesit në fushën e caktuar.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Çfarë ndodh me ushqimin në zorrë?**

Fjalët kyçe: *zorrë, mëlqi, karbohidrate, zorrë e trashë, simbiozë, baktere*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Përshkruan ndërtimin e gypit tretës nga lukthi deri te vrima anale

Shpjegon rolin e mëlqisë dhe pankreasit në tretjen e ushqimit

Vlerëson praninë e kolibaktereve në zorrën e trashë

Kriteret e suksesit:

Emërto gypin tretës

Veco rëndësinë e pankreasit në tretjen e ushqimit

Sqaro simbiozën e kolibaktereve me zorrët përmes një shembulli

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri “Biologjia 7“, llaptopi, projector, model sistemi tretës

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Kimi, TIK

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

IMAGJINATË E DREJTUAR

Mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve të qëndrojnë në heshtje dhe të mendojnë çfarë ndodh me ushqimin në zorrë. U kërkohe të qëndrojnë kështu për rreth 2 minuta Mësimdhënësi/ja drejton pyetjet: - Si ndërtohet sistemi zorror? (ndërtohet nga: zorra dymbëdhjetëgjishtore, zorra e hollë, zorra e trashë) - Cili është roli i lëngjeve që derdhen nga organet e caktuara në zorrë? (zbërthejnë karbohidratet, yndyrat dhe proteinat). Lihen nxënësit të lirë të thonë atë çka ata imagjinojnë, pa ndërhyrë apo komentuar.

LEXIM DHE PYETJE

Pas diskutimit të zhvilluar në fazën e parë, mësimdhënësi/ja shtron pyetjet: Me cilin pjesë (organ) fillon sistemi zorror dhe cili është roli i saj? Ç' ndodh në mëlçi? Cilat lëndë absorbohen nga zorra e hollë? Çka absorbohet nga zorra e trashë dhe çka hedhet nga kjo zorrë jashtë organizmit? Cili është roli i kolibaktereve në zorrën e trashë? Njëkohësisht mësimdhënësi/ja i fton nxënësit për të gjetur përgjigjet e duhura, duke lexuar tekstin. Ndahet teksti në paragrafe. Nxënësit do të punojnë në dyshe. Ata do të lexojnë paragrafët e do të vendosin së bashku se cilat janë termat kryesorë. Këta terma do t'i shkruajnë anash tekstit. Pasi nxënësi i parë mbaron së lexuari paragrafin e parë, nxënësi i dytë bën pyetje për tekstin, duke përdorur termat e shkruar anash. Nxënësi i dytë e shkruan pyetjen në skedë të vogël. Pasi nxënësi i dytë bie dakord me përgjigjen e nxënësit të parë, ata e shkruajnë atë në pjesën e pasme të skedës. Vazhdohet duke këmbyer rolet derisa të lexohet i gjithë teksti. Mësimdhënësi/ja ndalon nxënësit pas leximit të paragrafit të parë, rishikon termat, pyetjet, përgjigjet dhe sugjeron korrigjime. Vepron kështu në përfundim të leximit të çdo paragrafi sa herë e sheh të arsyeshme.

RRJEDHSHMËRIA GOJORE E DYSHES

Nxënësit do të punojnë në dyshe për të “përmbledhur” atë që lexojnë e mësojnë. Nxënësi 1 për 60 sekonda do t'i tregojë shokut diçka që mban mend nga pjesa që lexoi. Për 1 minutë nxënësit ndërrojnë rolet. Tani, nxënësi 2 do t'i tregojë shokut ç' gjë interesante mësoi, por duke u kujdesur të mos përsërisë ato çka i tha shoku. Vazhdohet kështu për 40 sekonda, 20 sekonda etj. (koha përcaktohet nga mësuesi). E rëndësishme është që nxënësit të rishikojnë materialin dhe të pyesin nëse kanë paqartësi.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informate kthyesë, vlerësim i ndersjelltë)

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit i udhëzojmë që në mënyrë individuale të hulumtojnë lidhur me tretjen e ushqimit në sistemin zorror.

REFLEKTIMI PËR ORË MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: III Klasa: VII

Tema (nga– plani dymujor):

Sistemi i organeve të njeriut

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

Vlerëson rëndësinë e mbrojtjes së sistemit të organeve të tretjes

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

III-1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.

V-2. Vlerëson përmbajtjen e vlerave pozitive dhe negative të paktën të tri llojeve të ushqimeve të cilat konsumohen në mjedisin e tij ose në rrethinë.

V3. Diskuton në grup moshatarësh, duke ofruar argumente, për rëndësinë që ka respektimi i regjimit ditor dhe i aktiviteteve fizike për shëndetin dhe për jetën e njeriut.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit,

qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Çrregullimet në aparatit tretës**

Fjalët kyçe: *kariesi, vjellja, diarreja, gastritis, verdhëza, apendiciti*

Rezultati/et e të nxënësve për orë mësimore:

Numëron çrregullimet më të zakonshme të organeve të tretjes

Tregon mënyrat se si duhet të kujdesemi për eliminimin e këtyre çrregullimeve

Vlerëson rëndësinë e mbrojtjes së sistemit të organeve të tretjes

Kriteret e suksesit:

Përshkruaj çfarë çrregullimi është gastritis e çfarë apendiciti

Numëro disa mundësi që ndihmojnë në shërimin e këtyre çrregullimeve

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri “Biologjia 7“, llaptopi, projector, model sistemi tretës

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Kimi, TIK

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

IMAGJINATË E DREJTUAR

Mësimdhënësi/ja fton nxënësit, njërin pas tjetrit, për të thënë ndonjë gjë që ata tashmë e dinë për çrregullimet ose sëmundjet e aparatit (sistemit) tretës. Vazhdoni derisa të mos ketë nga ata më informacione për to. Në këtë fazë të orës evidentohen njohuritë paraprake të nxënësve, e që shërbejnë edhe si vlerësim diagnostikues dhe mbi këto dije ndërtohet përmbajtja e re, e cila i motivon ata për të mësuar më shumë rreth çrregullimeve ose sëmundjeve të aparatit tretës. Shpjegoju nxënësve se njerëzit që ushqehen rregullisht dhe shëndetshëm kanë më pak gjasa të kenë çrregullime ose sëmundje në aparatit tretës.

DITARI DYPJESËSH

Pastaj ftohen nxënësit që të hapin librat faqe 47 të fillojnë leximin dhe pastaj të punojnë një ditar dypjesësh dhe reflektojnë për të. (përafërisht kështu)

Çrregullimet e aparatit tretës	Sqarimi
<i>Kariesi</i>	<i>Vrima e zezë në dhëmbë, shkaktohet nga bakteret e zakonshme që gjenden në zgavrën e gojës. Kujdesi: Pastrimi i rregullt i dhëmbëve, dhe vizitat e rregullta te stomatologu.</i>
<i>Vjellja dhe diarreja</i>	
<i>Gastriti</i>	

Ulçera	
Gurët e tëmthit	
Verdhëza	
Apendiciti	

DISKUTIM

Duke kërkuar nga nxënësit që pasi të kenë përfunduar plotësimin e tabelës me sqarimet përkatëse të pasuruar edhe me këshilla nga jeta e përditshme, të bëhet një përmbledhje e shpejtë të asaj që mësuam përmes teknikës lapsi në mes. Duke zgjedhur në mënyrë rastësore lapsin e nxënësit, fton që po i njejtë të numërojë disa nga çrregullimet e sistemit tretës, edhe për të njejtat të bëjë një përshkrim. Pastaj po i njejtë nxënës përmes zgjedhjes rastësore të lapsit për grupin tjetër të vazhdojë me përshkrimin e masave mbrojtëse ndaj këtyre çrregullimeve, duke vazhduar kështu deri sa të përfundojë përmbledhja e njësisë mësimore.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informate kthyes, vlerësim i ndersjelltë)

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hulumton në internet për çrregullimet ose sëmundjet e aparatit tretës.

REFLEKTIMI PËR ORË MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: III Klasa: VII

Tema (nga– plani dymujor):

Sistemi i organeve të njeriut

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

Hulumton dhe përshkruan ndërtimin dhe funksionin e sistemit të qarkullimit të gjakut. Analizon ndërtimin dhe punën e zemrës

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I-4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit

I 6. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

III-3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërin e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin

jetësorë të njeriut.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Sistemi i qarkullimit të gjakut**

Fjalët kyçe: *Zemra, veshëza, barkushe, aorta, arteriet, arteriolet, venat, venulat, kapilarët, pulsi*

Rezultati/et e të nxënësve për orë mësimore:

Emërton enët në të cilat qarkullon gjaku

Dallon qarkullimin e madh të gjakut dhe qarkullimin e vogël të gjakut

Përshkruan funksionimin e sistemit të qarkullimit të gjakut

Kriteret e suksesit:

Dallo venat, arteriet dhe kapilaret e gjakut

Krahaso qarkullimin e madh të gjakut dhe qarkullimin e vogël të gjakut

Trego rëndësinë e qarkullimit të gjakut

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri “Biologjia 7“, model qarkullimi i gjakut, forografi qarkullimi i gjakut, tensionmetër

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Kimi,

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

STUHI MENDIMESH

Mësimdhënësi/ja parashtron pyetjen: Çfarë kuptoni me pompim të zemrës, duke ditur paraprakisht se çfarë ndërtimi ka zemra? Nxënësit do të shënojnë në fletoret e tyre për 5 minuta dhe pastaj do t'i lexojnë disa nga ta.

HULUMTIM I PËRBASHKËT

Nga mësimdhënësi/ja prezantohet në fillim një prezantim në power point (ppt) - laptop, projektor, ku paraqitet një video e aktivitetit të zemrës, ku vërehet pompimi i zemrës dhe qarkullimi i vogël dhe i madh i gjakut, ky prezantim zgjat rreth 12 min. Pastaj kërkojmë nga nxënësit të lexojnë njësinë mësimore për 10 minuta, duke analizuar videon dhe tekstin që lexuan të përgjigjen se çfarë kuptuan nga ky prezantim, duke parashtruar pyetjet për të arritur rezultatet. 1. A e dini se cilat organe përbëjnë sistemin e qarkullimit të gjakut? 2. Prej cilës pjesë të zemrës shkon gjaku nga zemra në trup dhe në cilën pjesë të zemrës kthehet nga trupi? 3. Prej cilës barkushe dhe cilës arterie gjaku shkon në mushkëri dhe nga mushkëria në cilën veshëz të zemrës kthehet? 4. Cilat enë e bartin gjakun nga zemra në trup dhe cilat nga trupi në zemër dhe si quhen degëzimet e fundit të tyre?

USHTRIME

Matja e shtypjes së gjakut me tensionmetër. Për ushtrim është i nevojshëm: Tensionmetri. Mate shtypjen tënde të gjakut, kurse pastaj shtypjen e prindërve tuaj ose ndonjë personi më të vjetër se ju. Shëno çka vëren? Mendo cilat do të mund të ishin shkaqet për dallimet e shtypjes së gjakut? b) Matja e pulsit. Këtë ushtrim e realizon në orën e biologjisë. Me mollëzat e gishtit tregues dhe të mesëm, shtyp në anën e brendshme dorën ku ndodhet arteria radiale. Në atë rast do ta ndjesh pulsën. Numëro pulsën gjatë një minute. Pastaj kërko nga kolegu të bëjë

ndonjë aktivitet fizik dhe pastaj prapë i mat pulsën. Çfarë ndryshimesh verën? Mendoni, pse pulsi ndryshon në varësi nga gjendja e aktivitetit të trupit? Shpjegoni në bashkëpunim me nxënësit e tjerë dhe mësimdhënësin/en.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informate kthyesë, vlerësim i ndersjelltë)

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit i udhëzojmë që në mënyrë individuale të hulumtojnë lidhur me ndërtimin e zemrës, enëve të gjakut dhe rrugët e qarkullimit të gjakut. Hulumtimi apo punimi i tyre mund të mbështetet në ndonjë punim paraprak, në libër, internet, broshurë.

REFLEKTIMI PËR ORË MËSIMORE

ASPEKTET E PËRSGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: III Klasa: VII

Tema (nga- plani dymujor):

Sistemi i organeve të njeriut

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

Hulumton përbërjen, rolin dhe rëndësinë e përbërësve të gjakut dhe limfës

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I-2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.

III 3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

III 10. Merr pjesë ose udhëheq një grup punues që bashkëpunon me përfaqësues të komunitetit për të ndihmuar moshatarët dhe anëtarët e tjerë të komunitetit që kanë probleme shëndetësore, sociale, ekonomike etj., raporton më pas me gojë ose me shkrim për përvojat personale të fituara.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Përbërja e gjakut dhe funksioni**

Fjalët kyçe: Gjaku, qelizat e kuqe të gjakut, qelizat e bardha të gjakut, pllakëzat e gjakut, plazma e gjakut, limfa, enët limfatike

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Liston elementet e gjakut

Definon funksionin e elementeve të gjakut

Shpjegon rolin e limfës

Kriteret e suksesit:

Identifiko nga figura elementet e gjakut

Shpjego rëndësinë e qelizave të gjakut

Përshkruaj funksionin e limfës

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri “Biologjia 7“, laptopi, projektor, fotografi,

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Kimi, Fizikë, TIK

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

MENDO SHUMË SHKRUAJ SHKURT

Orën mësimore mësimdhënësi-ja e fillon duke ju kërkuar nxënësve të plotësojnë konceptin “GJAKU VETË JETA” me fjalët që kanë mësuar dhe tashmë dijnë për gjakun, përbërësit e tij në përgjithësi.

Kështu psh: te shkronja A mund të shkruajnë qelizat e bardha të gjakut. Për realizimin e kësaj enigme nxënësit mund të punojnë në dyshe për 3-4 min. Pastaj ftoj që të reflektojnë dhe të shohim se çfarë kanë shkruar ata.

L

i

m L

f e

GJAKU VETË JETA

k

o

c

i

t

e

r

i

t

r

o

c

i

t

e

KUBIMI

Fillimisht ftohen nxënësit të lexojnë njësinë mësimore në libër dhe pastaj pjesa tjetër e orës vazhdon përmes teknikës Kubimi, mësimdhënësi-ja merr një kub në faqet e së cilit ka vendosur pyetje që kanë ndërlidhje me njësinë mësimore të mësuar më parë për gjakun dhe qarkullimin e tij në trup.

1.Numëro kush bënë pjesë në sistemin e qarkullimit të gjakut.

2.Dallo përbërësit e gjakut.



3.Përshkruaj eritrocitet dhe trego funksionin e tyre.

4.Analizon ndërtimin dhe funksionin e leukociteve.

5.Argumento tri ndryshimet kryesore të eritrociteve dhe leukociteve.

6.Vlerëso rolin e trombociteve dhe limfës në organizmin e njeriut.

Pasi nxënësit të kenë mbaruar leximin e njësisë mësimore, tani i kanë gjetur edhe përgjigjet e pyetjeve për grup.



DISKUTIM

Pasi të kenë gjetur përgjigjet nxënësit ftohen të diskutojnë lidhur me pyetjet e parashtuara.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informate kthyses, vlerësim i ndersjelltë)

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punoni elementet e gjakut me mjetet të shtëpisë

REFLEKTIMI PËR ORË MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Biologji

Shkalla e kurrikulës: III

Klasa: VII

Tema (nga- plani dymujor):

Sistemi i organeve të njeriut

Rezultati i të nxënët të temës (nga plani dymujor):

Sqaron konceptet: imunitet, alergji dhe identifikon grupet e gjakut

Rezultatet e të nxënët për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I-6. *Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.*

III 3. *Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.*

III 5. *Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Imuniteti dhe alergjia**

Fjalët kyçe: *Imuniteti, alergjia, transfuzioni, grupet e gjakut, alergjenët, antitruptat*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Sqaron konceptin alergji

Dallon imunitetin e lindur dhe të fituar

Numëron grupet e gjakut

Kriteret e suksesit:

Identifiko faktorët që mund të shfaqin alergjinë

Sqaro rolin e vaksinimit

Trego rregullin e transfuzionit të gjakut

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri “Biologjia 7“, laptopi, projektor, fotografi,

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:


Gjuhë dhe komunikim, Kimi, Fizikë

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore realizohet përmes teknikës DI, DUA TË DI, MËSOVA

Në kolonën di shkruajnë fillimisht se çfarë dinë për njësinë mësimore bazuar në njohuritë e tyre paraprake. Pastaj lexojnë njësinë mësimore në libër dhe shtojnë pyetje se çfarë duan të dinë, ndërsa në kolonën mësova shkruajnë se çfarë kanë mësuar.

Deri sa të punojnë kolonën mësova në ekran shfaqë disa fotografi për të cilat kërkoj nga nxënësit t'i komentojnë.



DI	DUA TË DI	MËSOVA

REKOMANDIM

EKSPERIMENT

a) Përcaktimi i grupit të gjakut.

Për këtë ushtrim janë të nevojshme: pllaka e qelqit, test serumi A, test serumi B, shufër qelqi. Përshkrimi i eksperimentit: Në njërin skaj të pllakës me gropa pikohet test serumi A, kurse në tjetrin test serum B. Mbi to pikohet nga një pikë gjak dhe ngadalë përzihet secila me shufër të posaçme qelqi. Pastaj pritet 2-3 minuta dhe lexohen rezultatet. Nëse qelizat e gjakut ngjiten (aglutinohen) kur përzihen: Me serumin anti- A, grupi i gjakut është A.

Me serumin anti-B, grupi i gjakut është B.

Me të dy serumet anti-A dhe anti-B, grupi i gjakut është AB, ndërsa:

Kur qelizat e gjakut nuk ngjiten kur përzihen me serumin anti-A dhe anti-B, grupi i gjakut është O.

Vlerësim për nxënie (informata kthyesë, vlerësim i ndersjelltë)

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hulumtoni në internet, pasojat që mund të shkaktohen nga transfuzioni i gjakut prej personit me Rh+(pozitiv) te personi me Rh-(negativ) dhe anasjelltas.

REFLEKTIMI PËR ORË MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: III Klasa: VII

Tema (nga- plani dymujor):

Sistemi i organeve të njeriut

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani tremujor):

Emërton rrugët e frymëmarrjes, përshkruan ndërtimin dhe funksionin e tyre. Përshkruan mekanizmat e frymëmarrjes mushkërore dhe rregullimin e saj.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I-2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.

III-1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.

III 4. Shfrytëzon dosjen personale për identifikimin e përparësive dhe mangësive në funksion të vetëvlerësimit të

përparimit dhe përmirësimit të suksesit në fushën e caktuar.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Sistemi i organeve të frymëkëmbimit**

Fjalët kyçe: *frymëmarrje, trake, mushkëri, bronke, bronkiolo, alveole, diafragma.*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Përshkruan rrugën që ndjekë ajri nga ambient i jashtëm deri në alveole

Numëron organet ndihmëse që e ndërtojnë sistemin e organeve të frymëmarrjes

Sqaron ndikimin e aktivitetit fizik në procesin e frymëmarrjes

Kriteret e suksesit:

Identifikon nga figura organet e frymëmarrjes

Sqaro funksionin e organeve ndihmëse gjatë frymëmarrjes

Dallo ritmin e frymëmarrjes dhe frymënxjerrjes gjatë aktivitetit fizik

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri “Biologjia 7”, llaptopi, projector, fotografi,

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Kimi, Fizikë

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

PËRMBLEDHJE E STRUKTURUAR

Mësimdhënësi-ja u drejtohet nxënësve që të mbajnë frymën derisa të munden. Kur ata fillojnë të marrin frymë përsëri, pyeti pse ata filluan të marrin frymë. (Frymëmarrja mund të konsiderohet si një proces gjysmautomatik, sepse brenda kufijve të caktuar mund të ndikojmë vullnetshëm në normën e frymëmarrjes. Sistemi nervor autonom kontrollon frymëmarrjen, prandaj nga ne është nën kontroll të caktuar vetëm deri në një pikë.) Pastaj mësimdhënësi-ja u tegon nxënësve se do të mësojnë më shumë rreth frymëmarrjes dhe sistemit të organeve të frymëmarrjes në këtë mësim.

MINI LEKSION





Mësimdhënësi-ja u shpjegon shkurtimisht ndërtimin dhe funksionin e organeve të frymëmarrjes duke përdorur poster apo fotografi të organeve të frymëmarrjes, pastaj u kërkon nxënësve që të përcjellin një video të shkurtër në të cilën shihet qartë procesi i frymëmarrjes dhe rrugëtimi i molekulave të oksigjenit

<https://www.youtube.com/watch?v=ApUBmrXcswA> . Pasi të ketë mbaruar video u kërkon nxënësve të thonë se çfarë kuptuan, pastaj i udhëzon ata që të lexojnë njësinë mësimore faqe 60.

DISKUTIM

Pasi të ketë mbaruar leximi i fton ata të diskutojmë për atë që lexuan dhe shikuan paraprakisht në video. Rrjedhën e komentimit e udhëzon me pyetje si këto, duke e shoqëruar edhe me fotografi, dhe duke dhënë sqarime aty ku ka nevojë dhe duke përdorur edhe modelin e organeve të frymëmarrjes, të cilin paraprakisht e ke vënë në qarkullim në grupe gjatë leximit.

- Shpjego rolin e organeve të frymëmarrjes?
- Numëro fazat nëpër të cilat kalon frymëmarrja?
- Përshkruaj rrugën të cilën e përshkon ajri nga ambient i jashtëm?
- Emërto nga figura organet e frymëmarrjes?
- Numëro organet ndihmëse të frymëmarrjes?
- Trego rolin e laringut?
- Trego ku janë të vendosura mushkëritë dhe çfarë roli kanë?
- Shpjego ndërtimin e mushkërive?
- Analizo përse mushkëritë nuk dhëmbin?
- Trego ndikimin e aktivitetit fizik në procesin e frymëmarrjes?



Vlerësim për nxënie (informate kthyese, vlerësim i ndersjelltë)

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hulumtoni në internet organet që përbëjnë sistemin e frymëmarrjes.

REFLEKTIMI PËR ORË MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: III Klasa: VII

Tema (nga- plani dymujor):

Sistemi i organeve të njeriut

Rezultati i të nxënës të temës (nga plani dymujor):

Vlerëson rolin dhe domosdoshmërin e ruajtjes së organeve të frymëmarrjes si dhe faktorët që demtojnë organet e frymëmarrjes

Rezultatet e të nxënës për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I-2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.

III- 8. Menaxhon emocionet dhe ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve, mjetet që ka gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti, veprë arti (në klasë/shkollë apo gjetiu).

V- 8- Shpjegon, gjatë një debati, prezantimi, me gojë ose me shkrim, pasojat e përdorimit të duhanit, alkoolit, drogës dhe substancave të tjera të dëmshme për shëndetin dhe mirëqenien e individit.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërin e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Sëmundjet e rrugëve të frymëmarrjes dhe mushkërive**

Fjalët kyçe: *ftohje, tuberkuloz, bronkit, asma, kancer i mushkërive.*

Rezultati/et e të nxënës për orë mësimore:

Numëron disa sëmundje të organeve të frymëmarrjes

Definon arsyet që i shkaktojnë këto sëmundje

Vlerëson pse duhet ti ruajmë organet e frymëmarrjes

Kriteret e suksesit:

Sqaro tuberkulozin, asmen dhe bronkitin e mushkërive

Listo disa nga mënyrat si duhet ti mbrojmë organet e frymëmarrjes

Sqaro efektin e tymit të duhanit te personat joduhanpirës

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri “Biologjia 7”,

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Kimi, Fizikë

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

DI, DUA TË DI, MËSOVA

Pas një përsëritje të shkurtë të njësisë së kaluar mësimdhënësi-ja i fton nxënësit të shpalosin informacionet e tyre lidhur me atë se çfarë dinë lidhur me sëmundjet e organeve të frymëmarrjes. Ndërkohë i orienton nëse është e nevojshme pak me pyetje si e çfarë dini për tuberkulozin e mushkërive, çfarë dini për kancerin e mushkërive, a

ju ka ndodhur të jeni sëmurë nga bronhitisi, cilat ishin simptomat, çfarë ju rekomandoi mjeku etj, ndërkohë mendimet e tyre u kërkon t'i shkruajnë në kolonën DI.

Pastaj u kërkon nxënësve t'i hapin librat faqe 64, dhe të lexojnë njësinë mësimore në heshtje, dhe njëkohësisht të shkruajnë 2-3 pyetje për secilën sëmundje. Nëse është e nevojshme u ndihmon dhe mësimdhënësi-ja. Pasi të përfundojnë leximin fton disa nxënës që ti lexojnë pyetjet e tyre dhe i shkruan në kolonën Dua të di, të cilave më pas do u përgjigjen në kolonën Mësova

Si p.sh

DI	DUA TË DI	MËSOVA
	1. Cilat janë sëmundjet më të shpeshta të organeve të frymëmarrjes?	
	2. Si shkaktohet gripi?	
	3. Cilat janë simptomat e gripit?	
	4. Si shkaktohet tuberkulozi?	
	5. Cilat janë simptomat e tuberkulozit?	
	6. Përse merret vaksina Be-Se-Zhe?	
	7. Çfarë sëmundje është Bronkiti?	
	8. Çfarë sëmundje është Astma?	
	9. Sqaro efektin e tymit të duhanit te personat joduhanpirës	
	10.	

Nëse ka pyetje që janë shkruar në tabelë mirëpo ndonjëri nga nxënësit nuk e ka menduar këtë pyetje atëherë e plotëson në fletore. Pasi të janë përgjigjur secilës pyetje me radhë, fton nxënësit të diskutojnë se çfarë mësuat, cilat janë sëmundjet e organeve të frymëmarrjes,etj.

Vlerësim për nxënie (informate kthyesë, vlerësim i ndersjelltë)

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hulumtim si duhet ti ruajm organet e frymëmarrjes

REFLEKTIMI PËR ORË MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: III Klasa: VII

Tema (nga- plani dymujor):

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):

Sistemi i organeve të njeriut

Definon termin tajitje dhe emërton organet kryesore për tajitje te njeriu.

Analizon krijimin e urinës.

-Hulumton mundësitë e ruajtjes së sistemit të ekskretimit.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I-2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.

II- 1. Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/ problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në medie.

V- 8. Shpjegon, gjatë një debati, prezantimi, me gojë ose me shkrim, pasojat e përdorimit të duhanit, alkoolit, drogës dhe substancave të tjera të dëmshme për shëndetin dhe mirëqenien e individit.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Sistemi i organeve të ekskretimit**

Fjalët kyçe: *veshkët, glomeruli, tubuli, kripa, fshikëza urinare*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Përshkruan ndërtimin e organeve të ekskretimit

Definon cila është detyra e veshkëve në trupin tonë

Vlerëson rëndësinë e organeve të ekskretimit

Kriteret e suksesit:

Emërto nga figura organet e ekskretimit

Analizo rolin e veshkëve

Trego rëndësinë e ruajtjes së organeve të ekskretimit

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri “Biologjia 7“, model- sistemi i organeve të ekskretimit, projektor, laptop

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Tik, Kimi, Art Figurativ

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

MENDONI, PUNONI, DISKUTONI,

Mësimdhënësi/ja sjell në klasë një veshkë model ose të freskët viçi (në dispozicion në një mishtore ose në sektorin e mishit të një supermarketi). Veshka model fillon të analizohet menjëherë, ndërsa në rastin e veshkës së freskët së pari vërehet ureteri, arteria veshkore dhe vena. Pastaj, duke përdorur një thikë të mprehtë, pren veshkën për së gjati, ashtu që palca dhe korja qartë të jenë të dukshme. U jep nxënësve mundësinë që t'i analizojnë këto struktura. Pastaj diskutojnë funksionin e secilës strukturë në filtrimin e gjakut dhe formimin e


urinës.

MINILEKSION

Pjesën kryesore të ores mësimore mësimdhënësi/ja e realizon fillimisht duke ftuar nxënësit të shikojnë një video në të cilën sqarohet ndërtimi i organeve që e ndërtojnë sistemin e organeve të ekskretimit.


[youtube.com/watch?v=4Ie91UhNbjY](https://www.youtube.com/watch?v=4Ie91UhNbjY)

Funksioni I veshkëve, ndërtimi I nefronit. Krahas videos mësimdhënësi/ja u shpjegon nxënësve ndërtimin e organeve të ekskretimit, pastaj i fton nxënësit të hapin librat faqe 67 dhe të fillojnë leximin e njësis mësimore. Dhe në pika të shkurtëra të bëhet një sqarim nga nxënësit për ndërtimin e veshkëve, nefronit dhe funksionin e tyre, krijimin e urinës, duke shfrytëzuar fotografitë nga libri, dhe modelin e ndërtimit të veshkëve.



KLLASTER

Pasi të përfundojë pjesa e shtjellimit të temës mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve të mbyllin librat dhe me informacionet e fituara të ndërtojnë një kllaster të cilin pastaj e realizojnë në tabelë me ndihmen e disa nxënësve në formë përmbledhje, (përafërsisht kështu).



Vlerësim për nxënie (informate kthyesë, vlerësim i ndersjelltë)

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Të hulumtojnë nxënësit në internet video ku mund të shihen gurët në veshka etj. Në bazë të asaj që kanë parë shënojnë në fletore, pastaj diskutojnë në orën e ardhshme të biologjisë.

REFLEKTIMI PËR ORË MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: III Klasa: VII

Tema (nga– plani tremujor):

Sistemi i organeve të njeriut

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani tremujor):

Hulumton ndërtimin dhe funksionimin e sistemit nervor.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I-3. Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.

I -6. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

III 3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Sistemi nervor dhe hormonal (endokrin)**

Fjalët kyçe: *Sistem nervor periferik, neurone, dendrite, akson, sinjal, nerva*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Përcakton kush e ndërton sistemin nervor

Përshkruan ndërtimin e qelizës nervore

Shpjegon funksionimin e sistemit nervor

Kriteret e suksesit:

Dallo pjesët përbërëse të sistemit nervo periferik

Emërto nga figura pjesët përbërëse të neuronit

Jep të paktën një shembull të mënyrës së përcjelljes së sinjalit nervor.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri “Biologjia 7“, laptop, projektor, fotografi, fleta të bardha,

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Tik, Kimi, Art Figurativ

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE



STUHI MENDIMESH (e modifikuar)

Fillimisht mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit të tregojnë se çfarë dinë për sistemin nervor, u kërkon që fillimisht të mendojnë e pastaj mendimet e tyre ti shkruajnë në një letër të bardhë të palosur në atë mënyrë që secili brenda grupit do të ketë mundësi të shkruaj mendimin pa u ndikuar nga mendimi i tjetrit, dhe fleta të bartet nga njëri nxënës tek tjetri deri sa të gjithë të shkruajnë mendimet e tyre. Fletat e palosura i merr

mësimdhënësi/ja dhe i lë për pjesën e fundit të ores mësimore që vetë nxënësit që bëjnë vetëvlerësimin.

MINI LEKSION

Pastaj mësimdhënësi/ja duke shfrytëzuar fotografi nga interneti shfaq në ekran ndërtimin e sistemit nervor, qelizën nervore, dhe në pika kyqe u sqaron atyre se nga cilat pjesë është i ndërtuar sistemi nervor, si ndahet sistemi nervor, si bartet informacioni nga ambienti i jashtëm deri në tru dhe përpunohet e kthehet prap në formë të veprimt. Nga cilat pjesë është e ndërtuar qeliza nervore, çfarë funksioni kanë neuronet.



Pastaj kërkon nga nxënësit ti hapin librat dhe të fillojnë të lexojnë në heshtje njësinë mësimore faqe 72. Dhe të bëjnë me shenjë ndonjë informacion të cilin nuk e kanë kuptuar në mënyrë që të ju jap sqarime pastaj në fund. Ndërkohë sa ata lexojnë mësimdhënësi/ja në tabelë shkruan disa koncepte (pyetje) për të cilat nxënësit do të përgjigjen pasi të kenë përfunduar leximin.

TABELA E KONCEPTEVE

Konceptet (pyetjet)	Shpjegimet
<p>Shpjego ndërtimin e sistemit nervor? Përshkruaj ndërtimin e qelizës nervore? Emërto pjesët e qelizës nervore nga fotografia? Trego si ndahen neuronet për nga funksioni? Shpjego për çfarë shërbejnë neuronet ndijore, lëvizore, asociative? Trego qendrën e sistemit nervor periferik? Përshkruaj si përcillet informacioni nga mjedisi i jashtëm deri në tru? Si janë të ndërtuara nervat?</p>	

Pasi që nxënësit të kenë mbaruar leximin i fton ata që të reflektojnë për tabelën e punuar e që rrjedhimisht gjatë reflektimit shohim se ata po përgjigjejn për konceptet e shkruara në tabelë.

Pastaj mësimdhënësi/ja pyet nxënësit nëse kanë diçka të paqartë nëse ka dikush ndonjë pyetje ju jap përgjigje, pastaj merr fletat e palosura dhe i lexon mendimet një nga një dhe pasi të mbaroj fjalja e parë pyes nxënësit se a është i drejt apo i gabuar mendimi i shkruar në fletë, kështu nxënësit vetëvlerësojnë informacionet e tyre paraprake si të sakta apo të gabuara. (Mendimet janë shkruar pa emër të nxënësve).

*Arsyeja pse punohet me këtë metodë është që nxënësit të shkruajnë menimet e tyre dhe të bartin te shoku/shoqja fletën pasi kështu ndodh edhe me qelizat nervore, informacioni vjen nga jashtë (në këtë rast kërkesa e mësimdhënësit-es) bartet nga një qelizë në tjetren (nxënësit bartin letren nga nxënësi në nxënësi). Pastaj

përpunohet infomata nga sistemi nervor (analiza gjatë leximit) dhe kthehet përgjigjia (nxënësit e vlerësojnë mendimin nëse ishte i saktë apo i gabuar).

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime)

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Udhëzoni nxënësit që përmes internetit të gjejnë video, ku mund të vrojtojnë transmetimin e impulsive nervore

REFLEKTIMI PËR ORË MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: III Klasa: VII

Tema (nga– plani tremujor):

Sistemi i organeve të njeriut

Rezultati i të nxënësve të temës (nga plani tremujor):

Analizon ndërvatësin e pjesëve të sistemit nervor.

Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I-3. Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.

I-6. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

III 3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njëësia mësimore: **Sistemi nervor qendror**

Fjalët kyçe: Truri, palca kurrizore, truri i madh, hemisferat e trurit, truri i ndërmjetëm, talamusi dhe hipotalamusi, truri i mesëm, truri i vogël, palca e zgjatur

Rezultati/et e të nxënësve për orë mësimore:

Përshkruan ndërtimin e trurit

Emërton pjesët e trurit, dhe përcakton funksionet e secilës pjesë të trurit,

Vlerëson ndikimin e mjedisit në funksionin e trurit,

Analizon ndërvatësinë e organeve të trupit tonë nga sistemi nervor.

Kriteret e suksesit:

*Identifiko pjesët e sistemit nervor qendror
Trego funksionet kryesore të sistemit nervor qendror
Përcakto pjesët e trurit dhe palcës kurrizore,
Trego ndikimin e mjedisit në zhvillimin e trurit.*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri “Biologjia 7“, lllaptop, projektor, fotografi, fleta të bardha,

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Tik, Kimi, Art Figurativ

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

SHKRIM I SHPEJTË

Mësimdhënësi/ja sjell në klasë një model të trurit. Gjeneron një vullnetar dhe kërkoni nga ai (duke i ndihmuar dhe ju) të përcaktojë llojet e trurit. Kërkoni nga nxënësit të shkruajnë shpejt në fletë, për ndërtimin dhe funksionet e trurit.

PYETJE DHE PËRGJIGJE, PUNË NË GRUPE

Udhëzimi i diferencuar. Shkruani pesë pyetjet më poshtë në tabelë. U thoni nxënësve të mendojnë se si do t'u përgjigjeshin pyetjeve. Pastaj nxënësit diskutojnë në grupe, duke u munduar të gjejnë përgjigjet sa më të sakta.

Pyetjet.

- 1. Trego në sa hemisfera ndahet truri i madh dhe shpjego çka na mundëson secila prej tyre.*
 - 2. Prej sa pjesëve përbëhet truri i ndërmjetëm dhe përshkruaj funksionet e tij?*
 - 3. Përshkruaj punën e trurit të mesëm dhe të vogël.*
 - 4. Shpjego rëndësinë e palcës së zgjatur.*
 - 5. Sqaro ç' është inteligjenca.*
- Në fund, një përfaqësues i grupit prezanton përgjigjet.*

MBAJTJA E STRUKTURUAR E SHËNIMEVE

Nxënësit janë të ndarë në grupe me 4-5 nxënës dhe zhvillojnë veprimtarinë e përshkruar në libër. Nxënësit vëzhgojnë dhe mbajnë shënime në grup. Mësimdhënësi/ja ndjek nga afër punën e grupeve dhe përmbledh në dërrasë përgjigjet e tyre. Nxënësit udhëzohen të plotësojnë fletoren e punës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informate kthyesë, vlerësim i ndersjelltë)

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësve u kërkohet të hulumtojnë në internet për rolin e hemisferës së majtë dhe të djathtë.

REFLEKTIMI PËR ORË MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: III Klasa: VII

Tema (nga– plani tremujor):

Sistemi i organeve të njeriut

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani tremujor):

Palca kurrizore dhe lëvizjet refleksive

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I-2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.

I- 6. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

III- 5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërin e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Palca kurrizore dhe lëvizjet refleksive**

Fjalët kyçe: *Palca kurrizore, lëng trunoro-palcor, lëndë e hirtë, lëndë e bardhë, fijet e nervave motorike, fijet e nervave sensitive, refleks, refleksët e lindura dhe të mësuara*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Përshkruan ndërtimin e palcës kurrizore dhe funksionet e saj

Shpjegon se si perceptohen dhe interpretohen stimujt ndijorë

Kriteret e suksesit:

Trego ndërtimin, shtrirjen dhe përbërjen e palcës kurrizore

Analizo harkun refleksiv

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri “Biologjia 7“, laptop, projektor, fotografi, fleta të bardha,

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Tik, Kimi, Art Figurativ

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

DISKUTIM PËR NJOHURITË PARAPRAKE

Shënohet në tabelë (ose në fletë të madhe të bardhë) shprehja refleks. Lihen nxënësit për tre minuta të renditin në fletët e tyre fjalët që lidhen me këtë term. Më pas pyetën nxënësit për fjalët, lidhjet a marrëdhëniet rreth termit dhe shkruhen ato në tabelë ose në fletë. Aktivizohen të gjithë nxënësit. Kur secili të ketë ofruar një lidhje, u kërkohet të japin ide të mëtejshme. Renditen në tabelë mendimet e tyre (pa i komentuar ato). Nxiten të pyesin

rreth termave për t'i qartësuar ato dhe për të zgjeruar të kuptuarit e tyre. (Që në fillim të etapës u kujtohet nxënësve të respektojnë njëri-tjetrin gjatë diskutimit).

LEXIM I DREJTUAR

Lexohet titulli “Palca kurrizore dhe lëvizjet refleksive” (paragrafi i parë). Nxënësit japin parashikimin e tyre për përmbajtjen e paragrafit. Pastaj lexohet nëntitulli “Lëvizjet refleksive - reagime të pavullnetshme” dhe bëhet krahasimi i informacionit me atë që parashikuan ata. Në këtë moment mësimdhënësi/ja sqaron koncepte a pyetje që mund t’u lindin nxënësve. Kështu vazhdohet dhe me paragrafin e nëntitullit “Reflekset e lindura dhe të mësuara”.

SHKRIM I LIRË

Shkrim i lirë me temën “Reflekset e lindura dhe të mësuara”. Nxënësit punojnë të pavarur për disa minuta. Bëhet vlerësimi i disa nxënësve, duke pasur parasysh dhe punën e bërë në fazat e tjera. Udhëzohen nxënësit të plotësojnë fletoren e punës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime)

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Të eksperimentojnë qarkun reflektiv të krahut dhe gjurit

REFLEKTIMI PËR ORË MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: III Klasa: VII

Tema (nga– plani tremujor):

Sistemi i organeve të njeriut

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani tremujor):

Hulumton ndërtimin dhe funksionimin e sistemit nervor

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I-4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.

I-6. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

III 5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: ***Sistemi nervor autonom (vegjetativ)***

Fjalët kyçe: *Sistem nervor autonom, rritje e veprimeve, zemra, syri, truri.*

Rezultati/et e të nxënët për orë mësimore:

Përshkruan veprimin e sistemit nervor autonom

Identifikon qendrat e simpatikut dhe parasimpatikut në sistem nervor

Kriteret e suksesit:

Jep shembuj nga jeta e përditshme e veprimit të simpatikut dhe parasimpatikut.

Dallo sistemin nervor autonom nga ai somatik.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri “Biologjia 7”, llaptop, projector, fotografi, fleta të bardha,

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Tik, Kimi, Art Figurativ

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

IMAXHINATË E DREJTUAR

Fillimisht mësimdhënësi/ja u kërkoj nxënësve të përcjellin një video të shkurtë për ndërtimin e sistemit nervor vegjetativ, ndarjen e tij dhe funksionin e tij në detaje.

<https://www.youtube.com/watch?v=GT7fhT6IZiQ&t=144s>

Pastaj u kërkoj të komentojnë çfarë shikuan, në video, a kishte informacione të reja , çfarë ju sillej në mendjen sapo shikuan videon. Gjithashtu mund të japin komente shitesë apo shembuj nga jeta e përditshme lidhur me funksionimin e sistemit nervor autonom.

INSERT

Mësimdhënësi/ja i udhëzoj nxënësit të hapin librat dhe të fillojnë leximin e njësisë mësimore, dhe përkrah leximit të vendosin shenjat përkatëse si : , +, -, ?. Nënvizimet e bëra në libër hidhen në tabelën e INSERT-it. Pra, pjesët kryesore të mësimin të shënuara me shenjat përkatëse hidhen në tabelë (shenja vendoset për atë pjesë që nxënësi e di, shenja + për atë pjesë që është shtuar e re për të, shenja – për pjesën që nuk e di dhe shenja ? - për atë pjesë që nuk e kupton)

<input checked="" type="checkbox"/>	+	-	?

Pasi të ketë mbaruar leximi dhe punimi i tabelës insert, mësimdhënësi/ja i fton nxënësit të diskutojnë për mënyrën e plotësimit të saj, fillimisht fton nxënësit që janë më të tërhequr në diskutime në mënyrë që edhe ata të marrin pjesë në mësim në mënyrë active. Kështu vazhdojnë deri sa të përfundojë teksin nga libri.

DISKUTIM

Shkruani tri pyetjet më poshtë në tabelë. U thoni nxënësve të mendojnë se si do t'u përgjigjeshin pyetjeve. Pastaj nxënësit diskutojnë në grupe, duke u munduar të gjejnë përgjigjet sa më të sakta.

Pyetjet:

1. Shpjego kur vihet në veprim sistemi nervor parasimpatik e kur ai simpatik?
2. Sqaro se a kanë shumica e organeve kontroll të dyfishtë, do të thotë nga sistemi parasimpatik dhe ai simpatik, nëse po, trego ndonjë shembull?
3. Trego ku e ka qendrën sistemi nervor simpatik dhe ku ai parasimpatik?

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informate kthyses, vlerësim i ndersjelltë)

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Zgjidhni një organ të trupi të njeriut dhe krijoni një monolog të shkurtër, duke e vënë veten në rolin e një organi, p.sh, truri. (Në ese përfshini të dhëna si: madhësinë e formën, vendndodhjen në organizëm, sistemin e organeve ku bëni pjesë, funksionin që kryeni etj. Ju mund ta vizatoni dhe ta pritni figurën e organit, që të luani lojë me role ne klasë.)

REFLEKTIMI PËR ORË MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: III Klasa: VII

Tema (nga- plani tremujor):

Sistemi i organeve të njeriut

Rezultati i të nxënësve të temës (nga plani tremujor):

Analizon mundësinë për kujdesin ndaj sistemit nervor dhe pasojat në rast dëmtimi.

Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I-2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.

I- 6. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

III- 5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Dëmtimet dhe sëmundjet e sistemit nervor me pasojat të mëdha për shëndetin**

Fjalët kyçe: Dhimbjet e kokës, tronditjet, alivanosja, dëmtimi i palcës kurrizore, paraliza trunore, epilepsia,

migrena, skleroza, meningjiti

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Identifikon dëmtimet dhe sëmundjet e sistemit nervor

Analizon shkaqet dhe pasojat e dëmtimeve dhe sëmundjeve të sistemit nervor dhe mundësitë për kujdesin

Kriteret e suksesit:

Shpjego disa nga dëmtimet dhe sëmundjet e sistemit nervor

Numëro shkaqet dhe pasojat e dëmtimeve dhe sëmundjeve të sistemit nervor dhe mundësitë për kujdesin

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri “Biologjia 7“, llaptop, projector,

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Tik, Kimi, Art Figurativ

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

MINILEKSION

Mësimdhënësi prezanton disa nga dëmtimet dhe sëmundjet e sistemit nervor me shembuj vizualë. U themi nxënësve t'i shikojnë librat, pastaj i pyesim nxënësit se çfarë lloje të sëmundjeve janë paraqitur në shembujt vizualë.

LEXIM DHE DISKUTIM

Udhëzoi nxënësit të lexojnë njësinë mësimore në libër për 10'. Ata lexojnë secili në grupe dëmtimet nga një sëmundje. Pastaj parashtrajmë pyetjet për shkaqet dhe pasojat e secilës nga dëmtimet dhe sëmundjet e sistemit nervor. Përgjigjet i shkruajmë në tabelë dhe fillon diskutimi.

HULUMTIM DHE DISKUTIM

Udhëzoni që nxënësit të bëjnë hulumtimin e lëndimit të palcës kurrizore në internet. Ata do të mësojnë më shumë rreth lëndimit të palcës kurrizore dhe paralizës, si dhe risitë teknologjike për të siguruar stimulim funksional elektrik për pacientët e paralizuar. Nxënësve do t'u kërkohet të reflektojnë se si zhvillimi i risive kërkonte bashkëpunimin e shumë shkencëtarëve dhe inxhinierëve.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime)

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Plotësim i fletore pune, duhet të emërtojnë dëmtimet dhe sëmundjet e sistemit nervor dhe të shkruajnë shkurtimisht për shkaqet dhe pasojat.

REFLEKTIMI PËR ORË MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: III Klasa: VII

Tema (nga– plani tremujor):

Sistemi i organeve të njeriut

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani tremujor):

Emërton gjëndrat me tajitje të brendshme të njeriut dhe përshkruan pozitën e tyre në trup. Përshkruan si gjëndrat endokrine kontrollojnë organe e funksione të caktuara nëpërmjet hormoneve.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I-4. *Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në formë të tjera të komunikimit.*

III-1. *Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën..*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njëësia mësimore: **Sistemi hormonal-endokrin**

Fjalët kyçe: *Sistemi endokrin, “mesazhe elektrike”, “mesazhe kimike”, hipofiza, epifiza, tiroidea, paratiroidea, timusi, pankreasi, gjëndra mbiveshkore, gjëndra seksuale*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Shpjegon se çfarë janë dhe si funksionojnë hormonet

Emërton gjëndrat e sistemit endokrin dhe përshkruan efektet dhe pozitën e tyre në trup

Kriteret e suksesit:

Sqaro se çfarë janë hormonet dhe si veprojnë ato

Numëro gjëndrrat endokrine në trupin tonë duke treguar për pozitën e tyre në trup

Përcakto funksionin që kanë në trupin tonë gjëndrat endokrine

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri “Biologjia 7”, llaptop, projector, fotografi, fleta të bardha,

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Tik, Kimi, Art Figurativ

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

STUHI MENDIMESH

Mësimdhënësi/ja parashtron pyetjen: Çfarë ndikon që disa njerëz kanë trup shumë të gjatë, gjigant, e disa shumë të shkurtër, xhuxh? Nxënësit do të shënojnë në fletoret e tyre për 5 minuta dhe pastaj do t'i lexojnë disa nga ta.

PYETJE DHE PËRGJIGJE

Udhëzim i diferencuar: Shkruani pesë pyetjet më poshtë në tabelë. U thoni nxënësve të mendojnë se si do t'u përgjigjeshin pyetjeve Pastaj nxënësit diskutojnë në grupe, duke u munduar të gjejnë përgjigjet sa më të sakta

Pyetje:

- 1. Trego dallimin në mes të sistemit nervor dhe atij hormonal*
- 2. Identifiko llojet e gjëndrave endokrine*
- 3. Përcakto vendndodhjet e hipofizës dhe epifizës dhe shpjego funksionet e tyre*
- 4. Çka prodhon tireoidea dhe paratireoidea dhe cilat janë çrregullimit që shkaktohen në organizëm nga mosfunksionimi normal i tyre?*
- 5. Cilat janë funksionet e pankreasit?*
- 6. Përshkruaj rolin e gjëndrave mbiveshkore*
- 7. Analizo funksionet e gjëndrave seksuale*

Në fund, nga një përfaqësues i grupit prezantohen përgjigjet.

MËSOVA MË SHUMË,

Udhëzoni nxënësit të plotësojnë tabelën në fletoren e punës: Të emërtojnë gjëndrat endokrine, efektin e hormonit kur është i mangët ose tepërt.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informate kthyesë, vlerësim i ndersjelltë)

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIMI PËR ORË MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VII
Tema (nga– plani tremujor): Sistemi i organeve të njeriut	Rezultati i të nxënit të temës (nga plani tremujor): Emërton dhe përshkruan organet shqisore në trupin tonë (shqisës së të parit, dëgjuarit, ekuilibrit, shijes, nuhatjes, shqisave lëkurore) si dhe analizon funksionin e tyre.		
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I- 6. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë. III- 3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet. IV-7. Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkollë apo jashtë saj)			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërin e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut. Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Sistemi i organeve ndijore (shqisore) sytë dhe shikimi			
Fjalët kyçe: <i>Sistemi i organeve ndijore, pjesët mbrojtëse, pjesët optike, receptorët e dritës, reflekset mbrojtëse</i>			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: <i>Emërton organet shqisore të trupit të njeriut</i> - Përshkruan ndërtimin e syrit - Përcakton reflekset mbrojtëse të syrit - Shpjegon si shohim ne Kriteret e suksesit: <i>Numëro organet shqisore</i> - Analizo pjesët përbërëse të syrit - Përshkruaj dhe shpjego si mbrohen sytë tanë - Krahaso syrin me mekanizmin e funksionimit të një aparati fotografik			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: <i>Libri “Biologjia 7”, llaptop, projector, model syri</i>			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: <i>Gjuhë dhe komunikim, Tik, Kimi, Art Figurativ</i>			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			

DI, DUA TË DI, MËSOVA MË SHUMË


Njësinë mësimore mësimdhënësi-ja i fillon duke kërkuar nga nxënësit të shpalosin informacionet e tyre lidhur me atë se çfarë dinë lidhur me organet ndijore e në veçanti për syrin, ndërkohë mendimet e tyre u kërkon t'i shkruajnë në kolonën DI.

Pastaj u kërkon nxënësve t'i hapin librat faqe 93, dhe të lexojnë njësinë mësimore në heshtje, dhe njëkohësisht të shkruajnë 2-3 pyetje për atë se çfarë u intereson të dijnë më shumë për syrin, nëse është e nevojshme u ndihmon dhe mësimdhënësi/ja. Gjatë leximit të njësisë mësimore mësimdhënësi-ja u ofron disa modele të syrit nxënësve të që ti shohin deri sa i lexojnë pjesët dhe ndërtimin e brendshëm të tij. Dhe pasi të përfundojnë leximin fton disa nxënës që ti lexojnë pyetjet e tyre dhe i shkruan në kolonën Dua të di, të cilave më pas do u përgjigjen në kolonën Mësova.

Si p.sh

DI	DUA TË DI	MËSOVA

Nëse ka pyetje që janë shkruar në tabelë, mirëpo ndonjëri nga nxënësit nuk e ka menduar këtë pyetje atëherë e plotëson në fletore. Pasi të janë përgjigjur secilës pyetje me radhë, fton nxënësit të diskutojnë se çfarë mësuuan. Derisa nxënësit plotësojnë kolonën mësova në ekran shfaqen disa fotografi të syrit dhe ndërtimit të tij. Gjithashtu në fund ftohen nxënësit të përcjellin një video për ndërtimin e brendshëm të syrit.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informatë kthyesë, vlerësim i ndersjelltë)

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Të hulumtojnë në internet për pjesët përbërëse të syrit, për atë që ndodh në pjesët specifike të syrit me dritën.

REFLEKTIMI PËR ORË MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: III Klasa: VII

Tema (nga– plani tremujor):

Sistemi i organeve të njeriut

Rezultati i të nxënësve të temës (nga plani tremujor):

Identifikon dëmtimet dhe masat mbrojtëse të shqisave.

Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkollës (të synuara):

II- 6. Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim

III- 3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

V- 10. Merr pjesë ose udhëheq një grup punues që bashkëpunon me përfaqësues të komunitetit për të ndihmuar moshatarët dhe anëtarët e tjerë të komunitetit që kanë probleme shëndetësore, sociale, ekonomike etj., raporton më pas me gojë ose me shkrim për përvojat personale të fituara

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: ***Të metat dhe sëmundjet e syrit***

Fjalët kyçe: *Shkurtpamësia, largpamësia, largpamësia e pleqërisë, trakoma, daltonizmi, katarakti*

Rezultati/et e të nxënësve për orë mësimore:

Identifikon të metat dhe sëmundjet e syrit

Përshkruan masat mbrojtëse të syrit

Shpjegon shkaqet dhe pasojat e të metave dhe sëmundjeve të syrit

Kriteret e suksesit:

Emërto të metat dhe sëmundjet e syrit

- *Përshkruaj sëmundjet e syrit*

- *Analizo shkaqet dhe pasojat e të metave dhe sëmundjeve të syrit*

- *Trego disa mënyra të mbrojtjes së syve*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri “Biologjia 7”, llaptop, projector,

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Tik, Kimi, Art Figurativ


PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

STUHI MENDIMESH

Mësimdhënësi/ja parashtron pyetjen: Çfarë dini për të metat dhe sëmundjet e syrit, fton nxënësit që fillimisht të mendojnë në heshtje për të metat e syrit dhe pastaj të diskutojnë për mendimet e tyre.

LEXIM- PËRMBLEDHJE NË DYSHE.

Mësimdhënësi/ja hap librin dhe u tregon nxënësve tekstin që do të punojnë në dyshe. Ndahet teksti në paragrafe, në mënyrë që ata ta kenë më të lehtë përpunimin e tekstit. Kjo procedurë është shpjeguar dhe një herë, por po e rikujtojmë. Njëri nga nxënësit lexon paragrafin dhe e përmbledh, ndërsa tjetri bën pyetje rreth materialit të përmbledhur. Në qoftë se shohim që paragrafi është përvetësuar, në paragrafin tjetër nxënësit ndërrojnë rolet. Mësimdhënësi/ja e ndjek nga afër punën e dysheve. Rëndësi u kushton përgjigjeve për pyetjet: Cilat janë të metat dhe sëmundjet e syve dhe pasojat nga to? Cilët janë shkaktarët e të metave dhe sëmundjeve të syrit? Ndërkohë shfaqë në ekran fotografi të shkurtërpaçsisë dhe largëpaçsisë.



Pamja normale

Shkurtpamësia

Largpamësia

KLLASTER

Paraqitet tema në tabelë me anë të një organizuesi grafik. Nxiten nxënësit të thonë të gjitha mendimet që lidhen me të metat dhe sëmundjet e syrit. Zgjidhet lideri i grupit që pastaj të thotë mendimet e grupit të tij. Mësimdhënësi/ja i shkruan ato në tabelë, duke u kujdesur që nxënësit të mos kritikojnë idetë e njëri-tjetrit.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informate kthyses, vlerësim i ndersjelltë)

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Plotësimi i fletore punës

REFLEKTIMI PËR ORË MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: III Klasa: VII

Tema (nga– plani tremujor):

Sistemi i organeve të njeriut

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani tremujor):

Emërton dhe përshkruan organet shqisore në trupin tonë (shqisës së të parit, dëgjuarit, ekuilibrit, shijes, nuhatjes, shqisave lëkurore) si dhe analizon funksionin e tyre. Identifikon dëmtimet dhe masat mbrojtëse të shqisave.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I-2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve**III- 3.** Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.**III- 5.** Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

*Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.**Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.***ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**Njësia mësimore: ***Veshi dhe dëgjimi, sëmundjet e veshit***Fjalët kyçe: *veshi i jashtëm, veshi i mesëm, veshi i brendshëm, tonet dhe shkallët në të cilat i dëgjojmë, zhurma e vazhdueshme*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*Përshkruan ndërtimin e veshit dhe rolin kryesor të tij**Shpjegon pasojat e sëmundjeve të veshit*

Kriteret e suksesit:

*Dallo pjesët e veshit**Analizo funksionin kryesor të veshit**Sqaro shkaqet dhe pasojat e dëmtimeve dhe sëmundjeve të veshit*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri “Biologjia 7”, laptop, projektor,

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

*Gjuhë dhe komunikim, Tik, Kimi, Art Figurativ***PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

PYETJE DHE PËRGJIGJE,

Udhëzim i diferencuar. Shkruani pesë pyetjet më poshtë në tabelë. U thoni nxënësve të mendojnë se si do t'u

përgjigjeshin pyetjeve. Pastaj nxënësit diskutojnë në grupe, duke u munduar të gjejnë përgjigjet sa më të sakta.

Pyetjet:


1. Shpjego rolin e lapës së veshit
2. Cilat detyra i kryejnë qimet dhe dylli në kanalin e veshit?
3. Sqaro mënyrën e ekuilibrit të shtypjes së ajrit në veshin e mesëm
4. Përcakto pjesët e veshit që realizojnë dallimin e fortësisë së tingullit
5. Cilat pjesë të veshit të brendshëm rregullojnë drejtpeshimin
6. Ç' është zëri?
7. Përcakto burimet e zhurmës nga mjedisi juaj që mund të shkaktojnë dëme në dëgjim

- Në fund, një përfaqësues i grupit prezanton përgjigjet.

PËRMBLEDHJE E STRUKTURUAR

Mësimdhënësi/ja prezanton temën dhe mjetet që do të përdoren, duke ngjitur në tabelë: foto, pamje të ndërtimit të veshit. Pastaj, pasi nxënësit i vëzhgojnë ato, mësimdhënësi/ja paraqet shkurt pikat kryesore të mësimin, duke i shkruar në tabelë ose në letër të madhe.

Shënon: Të dëgjuarit është aftësia jonë që të ndiejmë valët e zërit. Për shembull, kur flet në telefon: një fletë e hollë metalike në altoparlantin e telefonit lëkundet (valët elektrike i kthen në valë të zërit), këto dridhje (vibrime) janë tingujt që transmetohen në ajër, prodhojnë zërin dhe quhen valë zanore. Veshi është organi ndijor përgjegjës për pranimin e këtyre valëve. Veshi këto valë i kthen në impulse dhe i përcjell në qendrën e dëgjimit në tru, etj.



KLLASTER

Pasi të përfundojë pjesa e shtjellimit të temës mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve të mbyllin librat dhe me informacionet e fituara të ndërtojnë një kllaster të cilin pastaj e realizojnë në tabel me ndihmen e disa nxënësve në formë përmbledhje.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informate kthyesë, vlerësim i ndersjelltë)

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Të hulumtojnë në internet për ndikimin e faktorëve të ndryshëm në dëgjim.

REFLEKTIMI PËR ORË MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: III Klasa: VII

Tema (nga– plani tremujor):

Sistemi i organeve të njeriut

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani tremujor):

Emërton dhe përshkruan organet shqisore në trupin tonë (shqisës së të parit, dëgjuarit, ekuilibrit, shijes, nuhatjes, shqisave lëkurore) si dhe analizon funksionin e tyre. Identifikon dëmtimet dhe masat mbrojtëse të shqisave.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I-3. Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.

I 4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit

III- 5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: ***Organet ndijore për aromë, shije dhe prekje***

Fjalët kyçe: *Ndjenja e aromës, ndjenja e shijes, ndjenja e prekjes, papila, shkronjat e Brail-it*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Emërton dhe përshkruan organet ndijore për aromë, shije dhe prekje

Dallon rolin e organeve ndijore për aromë, shije dhe prekje

Tregon rendësinë e këtyre organeve për orientim

Kriteret e suksesit:

Identifiko dhe sqaro ndërtimin e organeve ndijore për aromë, shije dhe prekje

Shpjego funksionin e secilit nga organet ndijore (aromë, shije dhe prekje)

Analizo rendësin e tyre në jetën e përditshme.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri "Biologjia 7", mollë, parfum

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Tik, Kimi, Art Figurativ

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

IMAGJINATË E DREJTUAR,

Mësimdhënësi/ja merr në klasë një mollë të rurdhosur dhe një të freskët, dhe një parfum(aromatizues) të cilin e shpërndanë në një cep të klasës dhe pyetë nxënësit se çfarë po ndjejnë. Pastaj në grupe ju vendos mollët dhe i pyet se çfarë po ndjejnë sapo ta mbajnë në dorë mollën e freskët dhe atë të rurdhosur. Kështu rrjedhimisht zhvillon imaxhinatën tek nxënësit për temën që do të realizohet. Lihen nxënësit të lirë të thonë atë çka mendojnë, pa ndërhyrë apo komentuar.



LEXIM / PËRMBLEDHJE NË DYSHE

Nxënësit do të punojnë në dyshe. Ndahet teksti në paragrafe. Nxënësi i parë do të lexojë paragrafin e parë (organi ndijor për aromë) me zë dhe do të bëjë përmbledhjen e tij. Kërkohet nga disa nxënës të thonë përmbledhjen e paragrafit. Nëse është e nevojshme, jepen sugjerime nga mësimdhënësi/ja. Nxënësi i dytë bën pyetje rreth këtij paragrafi. Disa nxënës thonë pyetjet e tyre. Bëhen sugjerime për t'i përmirësuar ato. Nxënësi i parë jep përgjigjet e pyetjeve. Disa nxënës thonë përgjigjet e tyre e mësimdhënësi/ja ose nxënësit e tjerë mund t'i plotësojnë e saktësojnë ato. Vazhdohet kështu me çdo paragraf, duke këmbyer idetë e tyre. Mësimdhënësi/ja kujdeset të jepen përgjigje për pyetjet:

- 1. Nëse në një vend që ka erë qëndrojmë për një kohë më të gjatë, ne mësohemi dhe nuk e ndiejmë erën më. Thuaj pse ndodh kjo?*
- 2. Ne me anën e gjuhës perceptojmë 4 shije, por ne mendojmë se shijojmë shumë më tepër. Trego pse ndodh kjo ndjesi?*
- 3. Përshkruaj rolin e lëkurës si organ i prekjes.*

DISKUTIM

Pasi të ketë mbaruar leximi i fton atë të diskutojmë për atë që lexuan dhe tu përgjigjen pyetjeve. Rrjedhën e komentimit e udhëzon me pyetje, duke e shoqëruara edhe me fotografi, dhe duke dhënë sqarime aty ku ka nevojë dhe duke përdorur edhe modelin e gjuhës, të cilin paraprakisht e kam vënë në qarkullim në grupe gjatë leximit.

Udhëzime për eksperimente

Udhëzoni nxënësit të plotësojnë fletoren e punës. Ndani ata në tri grupe: njëri grup të udhëzohet për eksperimentin e parë, njëri për eksperimentin e dytë dhe tjetri për eksperimentin e tretë.

1. Përcaktimi i zonave në gjuhë për shije

Eksperimentin provoni së bashku me mësimdhënësi/en tuaj. Në orën e biologjisë, kur mësohet për organet ndijore sigurohet sheqer, ndonjë frutë peme të papjekur, kripë, limon. Prej tyre në gota të ndryshme bëhen tretjet dhe me ndihmën e shkopit të qelqit me pambuk të zhytur në njërën prej tretjeve, preket gjuha në vende të ndryshme. Largohet pambuku që është përdorur, vendoset tjetri dhe zhytet në tretjen tjetër. Pas secilit studim, personi duhet ta lajë gojën me ujë. Në përfundim dallon se në cilat vende më së miri ndihet shija e hidhur, e ëmbël, e kripur dhe e thartë?

Shënoje në fletoren e punës.

2. **Provoni ndjesinë e të nxehtëit në dorë** Eksperimentin provoni së bashku me mësimdhënësin/en tuaj. Për eksperiment janë të nevojshme: monedhat, kronometri.

Përshkrimi i eksperimentit: Të gjitha monedhat duhet të jenë sa më të ngrohta që të jetë e mundur. Vendosni monedhat në dorën e 5 nxënësve. Monedhat e ndryshme vendosni në anën e sipërme të dorës, siç tregon vizatimi. Përcillni për sa kohë presioni është i qëndrueshëm? Përpiquni për të shpjeguar ndjesinë e të nxehtëit në lëkurën e dorës.

3. **Provoni ndjesinë e nxehtëit dhe të ftohtëit në dorë** Eksperimentin provoni së bashku me mësimdhënësin/en tuaj. Për eksperiment janë të nevojshme: 3 enë me madhësi të barabartë, njëra me ujë të ftohtë, të vakët dhe të nxehtë jo mbi 40°. Fute një dorë në ujë të ftohtë për rreth 20 sekonda, pastaj secila futet veçmas në ujë të nxehtë dhe në fund mbaj të dy duart në ujë të vakët. Çfarë ndjeni? Përpiquni për të shpjeguar ndjesinë nga uji i ftohtë, të nxehtë dhe të vakët në lëkurën e dorës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informate kthyesë, vlerësim i ndersjelltë)

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hulumtojnë në internet për organet e ndjenjës së aromës, shijes dhe prekjës

REFLEKTIMI PËR ORË MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: III Klasa: VII

Tema (nga- plani tremujor):

Shumimi te njeriu

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani tremujor):

Përshkruan ndërtimin dhe funksionin e gjëndrave seksuale te njeriu

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I-7. *Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.*

III 8. *Menaxhon emocionet dhe ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve, mjetet që ka gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti, veprë arti (në klasë/shkollë apo gjetiu).*

IV- 7. *Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkollë apo jashtë saj).*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Sistemi i organeve të riprodhimit te njeriu**

Fjalët kyçe: *Organet e riprodhimit te mashkulli, testikujt, penisi, testosteroni, epididimisi, gypi farëpërcjellës, vezikula seminale, skrotumi, spermatozoidi, sperma: organet e riprodhimit te femra, qeliza vezë, ovulimi, gypa vezëpërçues, vagina, klitoris*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Identifikon organet riprodhuese të meshkujve dhe funksionet e tyre

Identifikon organet riprodhuese femërore dhe funksionet e tyre

Kriteret e suksesit:

Shpjego se si zhvillohet sistemi riprodhues i mashkullit

Shpjego se si zhvillohet sistemi riprodhues i femrave

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri “Biologjia 7”

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Tik, Kimi, Art Figurativ


PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

DISKUTIM PËR NJOHURITË PARAPRAKE

Nxënësit kanë mësuar në klasën e gjashtë për riprodhimin te njeriu dhe edukata seksuale. Shkruani titullin “Riprodhimi te njeriu” në tabelë dhe thirrni vullnetarët që të përcaktojnë atë (riprodhimin e mundësojnë organet e sistemit të riprodhimit, të cilat te femrat prodhojnë vezë, ndërsa te meshkujt spermatozoidet). U thoni nxënësve se në këtë njësi mësimore do të mësojnë për organet e riprodhimit seksual te meshkujt dhe femrat.

LEXIM / PËRMBLEDHJE NË DYSHE,

Nxënësit do të punojnë në dyshe. Ndahet teksti në paragrafe. Nxënësi i parë do të lexojë paragrafin e parë (organet e riprodhimit të mashkulli) me zë dhe do të bëhet përmbledhja e tij. Kërkoet nga disa nxënës të thonë përmbledhjen e paragrafit. Nëse është e nevojshme, jepen sugjerime nga mësuesi/ia. Nxënësi i dytë bën pyetje rreth këtij paragrafi. Disa nxënës thonë pyetjet e tyre. Bëhen sugjerime për t'i përmirësuar ato. Nxënësi i parë jep përgjigjet e pyetjeve. Disa nxënës thonë përgjigjet e tyre, e mësuesi/ia ose nxënësit e tjerë mund t'i plotësojnë e saktësojnë ato. Vazhdohet kështu me çdo paragraf, duke këmbyer idetë e tyre. Gjatë diskutimit shfrytëzon edhe disa poster- foto të ndërtimit të organeve riprodhuese.



Mësuesi/ia kujdeset të jepen përgjigje për pyetjet:

1. Përcakto organet seksuale parësore dhe dytësore të mashkullit
2. Cili është roli i testikujve?
3. Pse testikujt gjenden jashtë trupit?
4. Përshkruaj formimin e spermës
5. Çfarë rëndësie kanë vezoret?
6. Shpjego rolin që kanë gypat e Falopit
7. Përshkruaj ndërtimin e mitrës

KLLASTER

Pasi të përfundojë pjesa e shtjellimit të temës mësuesi/ia u kërkon nxënësve të mbyllin librat dhe me informacionet e fituara të ndërtojnë një kllaster të cilin pastaj e realizojnë në tabelë me ndihmën e disa nxënësve në formë përmbledhje.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informate kthyesë, vlerësim i ndersjelltë)

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Plotësoni fletoren e punës

REFLEKTIMI PËR ORË MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: III Klasa: VII

Tema (nga– plani tremujor):

Shumimi te njeriu

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani tremujor):

Tregon se sistemi riprodhues seksual, lehtëson procesin e trashëgimisë (bartjen e informatave gjetetike ose tipareve gjenetike nga një gjeneratë në tjetrën). Përshkruan shkurtimisht strukturat e sistemeve - riprodhuese te individit femër dhe mashkull si dhe funksionin e tyre në frytëzim.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

II-7. *Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike..*

III 5. *Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në formë të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.*

IV- 7. *Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj)*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: ***Nga pllenimi deri te lindja***

Fjalët kyçe: *Pllenimi, monozigot, placenta, kordoni i kërhizës, lëngu amniotik, fetusi, binjakët*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

- *Përshkruan proceset që ndodhin midis fazës së pllenimit (fekondimit) dhe fazës së lindjes*
- *Tregon si lindin binjakët*
- *Shënon momentet pas lindjes dhe përshkruan kujdesin dhe dashurinë e duhur të prindërve për fëmijën e tyre*

Kriteret e suksesit:

- *Analizo çfarë ndodh midis fazës së fekondimit dhe asaj të lindjes*
- *Përshkruaj mënyrën e lindjes së binjakëve*
- *Sqaro periudhën e paslindjes dhe shpjego cili duhet të jetë kujdesi dhe dashuria e prindërve për fëmijën e tyre*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri “Biologjia 7“


Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Tik, Kimi, Art Figurativ

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

IMAXHINATË E DREJTUAR

Vendosim në ekran një fotografi të tillë dhe mësimsdhënësi-ja pyet nxënësit se qfarë paraqet fotografia. Nxënësit fillimisht i fton të mendojnë në heshtje e pastaj të diskutojnë rreth mendimve të tyre.



MARRËDHËNIET PYETJE – PËRGJIGJE

Mësimsdhënësi/ja u kërkon nxënësve të lexojnë njësinë mësimore në libër dhe pastaj të fillojnë diskutimet. Në tabelë shkruan: Pllenimi, placenta, fetusit, binjakët. Pyet nxënësit, ç'janë këto shprehje? Pasi të përgjigjen, shkruani në tabelë mendimet e tyre. Në bashkëbisedim diskuton për pllenimin, rolin e placentës, zhvillimin e fetusit dhe për lindjen e binjakëve. U shpjegon nxënësve se në çdo ejakulim-derdhje gjenden miliona spermatozoide. Nga miliona spermatozoide, përafërsisht 100 prej tyre arrijnë te veza e pjekur. Vetëm një spermatozoid arrin të depërtojë në vezën e pjekur dhe të bashkohet me të.

- Pyetni: 1. Sa spermatozoide ekzistojnë në një ejakulim? (200 deri në 300 milionë)
2. Çka ndodh kur spermatozoidi hyn në vezë? (Bërthama e spermatozoidit, e cila përmban materiale gjenetike, shkrihet me bërthamën e vezës. Ky proces quhet pllenim)
3. Në cilin muaj dallojmë fetusin? (Pas 8 javësh dallohen të gjitha organet dhe quhet fetus)
4. Ku qëndron fetusit deri në lindje? (Fetusit qëndron duke lundruar në një qese të mbushur me lëng (lëngu amniotik), i cili e mbron atë nga goditjet)
5. Sa zgjat një shtatzëni normale? (9 muaj)
6. Pse lindin binjakët monozigot? (Kur vezoret e gruas lëshojnë vetëm një vezë të pjekur. Qeliza vezë e fekunduar gjatë ndarjes qelizore ndahet dhe qelizat shkëputen nga njëra-tjetra, pastaj prej tyre zhvillohen individë të veçantë) Diskutoni përse nuk mund të hyjnë spermatozoid të tjerë. Për arsyen pse një shtatzënë nuk duhet të përdorë alkool, të pijë duhan, të përdorë medikamente të caktuara etj. Arsyeto pse qumështi i nënës është i domosdoshëm për fëmijën? Përgjigjet që i marrim nga secili grup i shkruajmë në tabelë.

SHKRIM I SHPJETË

Mësimsdhënësi/ja shkruan për temën “Pse një foshnje ka nevojë për shumë dashuri” dhe nxënësit për një kohë të shkurtër (3-4 minuta) shkruajnë çfarë mësuan rreth temës. Lexohen disa prej punimeve të tyre dhe komentohen nga nxënësit.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informate kthyesë, vlerësim i ndersjelltë)

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hulumtim, ndryshimet në pubertet

REFLEKTIMI PËR ORË MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: III Klasa: VII

Tema (nga– plani tremujor):

Shendeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani tremujor):

Përshkuan ndryshimet e trupit gjatë rritjes, zhvillimit dhe ndikimin e reflektimeve të të tjerëve për shëndetin e tyre.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

III 1. *Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën..*

V- 6. *Vlerëson shkaqet e një situatë të mundshme të konfliktit midis moshatarëve ose midis anëtarëve të grupit dhe propozon alternativa për parandalimin e rrezikut dhe zgjidhjen më të mirë për ta, duke ndarë përvojat dhe mendimet për kohezionin e grupit.*

V-9. *Përshkruan ndryshimet fizike, psikike dhe emocionale të fazës së pubertetit duke paraqitur fakte për ndikimin e tyre në mënyrën (stilin) e jetesës.*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërin e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: ***Ndryshimet në pubertet dhe ndikimet e të tjerëve në shëndetin e tyre***

Fjalët kyçe: *Pubertet, adoleshencë, tension, shqetësim, tërheqje, nervozizëm*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

- *Shpjegon dallimet e individit të seksit femër nga ai mashkull*
- *Përshkruan ndryshimet fizike trupore dhe ato shpirtërore (emocionale) në periudhën e pubertetit*
- *Identifikon individët dhe qendrat e shërbimeve, ku adoleshenti mund të kërkojë ndihmë*

Kriteret e suksesit:

Dallo individin e gjinisë mashkullore dhe atë femërore

Identifiko ndryshimet fizike trupore dhe shpirtërore

Përcakto individët dhe institucionet ku adoleshenti të orientohet për ndihmë

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri “Biologjia 7” laptop, projektor


Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Tik, Kimi, Art Figurativ

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

IMAXHINATË E DREJTUAR

Vendosim në ekran një fotografi të tillë dhe mësimdhënësi-ja pyet nxënësit se qfarë paraqet fotografia. Nxënësit fillimisht i fton të mendojnë në heshtje e pastaj të diskutojnë rreth mendimve të tyre.



GRUPET E EKSPERTËVE

Mësimdhënësi/ja zgjedhë të punoj përmes grupeve të ekspertëve, nxënësit ndahen në grupe pune, dhe cakton numrat nga 1-4 për secilin nxënës të çdo grupi, u caktoj të orientohen në libër dhe të lexojnë secili nxënës nga një pjesë.

1-shat lexojnë: ndryshimet në periudhën e pubertetit te individët meshkuj

2-shat lexojnë: ndryshimet në periudhën e pubertetit te individët femra

3-shat lexojnë: ndryshimet emocionale, sociale dhe personale gjatë periudhës së pubertetit

4-shat lexojnë: individët dhe institucionet si të ndihmohet një adoleshent që të përballojë ndryshimet

Pasi nxënësit të kenë kuptuar pjesën e tyre, fton që në një grup të bashkohen numrat 1- nga të gjitha grupet, pastaj në grupin tjetër 2, në grupin tjetër 3-shat, në grupin tjetër 4-shat. Kështu të bashkuar fton nxënësit të

diskutojnë në mes tyre lidhur me atë çfarë lexuan, sa kanë mbajtur në mend, dhe këto informacione ti shkëmbejnë me njëri tjetrin. Pas pak minutash fton nxënësit të kthehen në grupet e tyre fillestare dhe aty të diskutojnë prap për atë çfarë mbajten në mend secili për pjesën e tyre.

DISKUTIM

Pasi të mbarojë diskutimi, brenda grupit për disa minuta fton nxënësit të fillojnë diskutimin së bashku, duke i ndihmuar me pak pyetje për orientim. (shembull i diskutimit)

1. Përshkruan dhe shpjegon ndryshimet në periudhën e pubertetit te individët meshkuj
2. Përshkruan dhe shpjegon ndryshimet në periudhën e pubertetit te individët femra
3. Përshkruan dhe shpjegon ndryshimet emocionale, sociale dhe personale gjatë periudhës së pubertetit
4. Emërtoni individët dhe institucionet si të ndihmohet një adoleshent që të përballojë ndryshimet.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informate kthyesë, vlerësim i ndersjelltë)

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Plotësimi i fletore

REFLEKTIMI PËR ORË MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: III Klasa: VII

Tema (nga– plani tremujor):

Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani tremujor):

Identifikon përgjegjësitë e prindësisë së hershme, rritjes së fëmijëve, planifikimit familjar, planifikimi në karrierë, kontracëpsionin, vendimmarrjen dhe kujdesin në rast të shtatzënisë.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):.

I 4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.

II 8. Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.

III- 3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: ***Përgjegjësitë prindore dhe planifikimi familjar***

Fjalët kyçe: *Përgjegjësitë prindërore, planifikimi familjar, planifikimi në karrierë, metodat natyrore,*

Rezultati/et e të nxënësve për orë mësimore:

- *Identifikon përgjegjësitë prindërore*
- *Përshkruan planifikimin familjar dhe të karrierës*
- *Dallon planifikimin familjar përmes metodave natyrore dhe artificiale*

Kriteret e suksesit:

Përshkruaj përgjegjësitë prindërore

Shpjego përparësitë dhe dobësitë e planifikimit familjar dhe të karrierës

Përshkruaj metodat e planifikimit familjar përmes metodave natyrore dhe artificiale

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri “Biologjia 7” laptop, projektor

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Tik, Kimi, Art Figurativ

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

STUHI MENDIMESH

Mësimdhënësi-ja pyet nxënësit çfarë dini për planifikimin familjar? Pret disa minuat që nxënësit të mendohen dhe pastaj fillon diskutimin....(ndërkohë paraqet në ekran disa fotografi si këto).



PËRMBLEDHJA E STRUKTURUAR

Mësimdhënësi/ja flet shkurt rreth përgjegjësiave prindërore, planifikimit familjar dhe në karrierë. Në këtë njësi mësimore sot do të mësojmë: për përgjegjësitë prindërore, planifikimin familjar dhe planifikimin në karrierë. Fton nxënësit të të lexojnë njësinë mësimore nga libri dhe pastaj i fton të diskutojnë.

DISKUTIM

Diskutimin e drejton me këto pyetje:

1. Cilat duhet të jenë përgjegjësitë prindërore?
2. Si mund të bëhet planifikimi familjar?
3. A dini çka do të thotë planifikim në karrierë?

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informate kthyesë, vlerësim i ndërsjelltë)

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hulumtoni në internet rolin e përgjegjësiave prindërore si dhe planifikimit familjar dhe në karrierë

REFLEKTIMI PËR ORË MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: III Klasa: VII

Tema (nga– plani tremujor):

Shendeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani tremujor):

Përshkruan sjelljet e rrezikshme, simptomat përcjelljen dhe parandalimin e STS dhe HIV.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I 3. Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim

III- 3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet

III- 5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: ***Sëmundjet që barten përmes kontaktit seksual***

Fjalët kyçe: *Sëmundjet seksualisht të transmetueshme, gonoreja, klamidia, sifilizi, herpesi, kondiloma, SIDA, HIV*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

- *Shpjegon se çfarë shkaktojnë sëmundjet seksualisht të transmetueshme (sëmundjet që barten përmes kontaktit seksual)*

- *Identifikon sëmundjet seksualisht të transmetueshme, të zakonshme, bakteriale*

- *Identifikon dhe përshkruan tri sëmundjet seksualisht të transmetueshme, të zakonshme, virale*

Kriteret e suksesit:

- *Analizo pasojat e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme dhe si mund të parandalohen ato*

- *Përshkruaj tri sëmundjet seksualisht të transmetueshme, të zakonshme, bakteriale*

- *Përshkruan tri sëmundjet seksualisht të transmetueshme, të zakonshme, virale*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri “Biologjia 7” laptop, projektor

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Tik, Kimi, Art Figurativ

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

STUHI MENDIMESH

Në këtë fazë mësimdhënësi/ja i thërret nxënësit të reflektojnë për njohuritë e tyre që kanë mbi sëmundjet seksualisht të transmetueshme. Reflektimet e nxënësve mësimdhënësi/ja i shënon në dërrasën e zezë, pa gjykuar për saktësinë e tyre. (ndërkohë sa nxënësit organizojnë mendimet e tyre, mësimdhënësi/ja shfaq në ekran disa fotografi të sëmundjeve seksualisht të transmetueshme).



HULUMTIM I PËRBASHKËT

Mësimdhënësi/ja i ndan nxënësit në gjashtë grupe dhe pastaj grupi i parë i jep disa pyetje që kanë të bëjnë me rezultatin e parë të pritsëm, ngjashëm bën edhe me grupet e tjera. Pastaj ai i udhëzon grupet që të lexojnë materialin e caktuar nga libri për sëmundjet seksualisht të transmetueshme. Nuk jep përgjigje, por vetëm material, ku mund të nënkuptohen përgjigjet. Mandej, secili grup i prezanton përgjigjet e veta. Nxënësit duhet të shtypin të paktën një ilustrim për të shtuar në fletën e tyre të fakteve, si p.sh. një foto e bakterit apo virusit që shkakton sëmundjen përkatëse dhe një foto të pasojave nga sëmundja. Pas kësaj, mësimdhënësi/ja e lejon një debat të nxënësve për përgjigjet e prezantuara.

KLLASTER

Pasi të përfundojë pjesa e shtjellimit të temës mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve të mbyllin librat dhe me informacionet e fituara të ndërtojnë një kllaster të cilin pastaj e realizojnë në tabel me ndihmen e disa nxënësve në formë përmbledhje.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informate kthyesë, vlerësim i ndersjelltë)

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Për më shumë informacion lidhur me sëmundjet seksualisht të transmetueshme, kontrolloni internetin. Shënoni në hapësirën bosh të fletores së punës çka dini për këto sëmundje dhe komentoni në klasë me nxënësit e tjerë.

REFLEKTIMI PËR ORË MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: III Klasa: VII

Tema (nga– plani tremujor):

Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani tremujor):

Shpjegon të drejtat seksuale për vete, të tjerët ligjet dhe rregulloret. - Vlerëson ndikimin e moshës, gjinisë, religjionit dhe kulturës në marrëdhënie me të tjerët..

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

II- 7. *Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.***VI 4.** *Shfaq mirëkuptim për personat të cilëve u është shkelur ndonjë e drejtë, duke ilustruar me shembuj nga jeta e përditshme nga mediet, të dhënat historike, personazhet nga romanet që ka lexuar apo nga filmat që ka parë në mënyrë që të mos përsëriten më.***VI 7.** *Identifikon paragjykimet që mund të ekzistojnë në shkollë dhe në rrethinë si dhe propozon veprime konkrete për luftimin e tyre.*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

*Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.**Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.***ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**Njësia mësimore: ***Të drejtat seksuale, ligjet dhe rregulloret***Fjalët kyçe: *Të drejtat seksuale, seksualitet, personat lezbikë, homoseksualë, biseksualë*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

- *Sqaron ç’ është seksualiteti dhe çka përfshijnë të drejtat seksuale, për vete dhe të tjerët*
- *Identifikon ligjet dhe rregulloret për të drejtat seksuale në vendin tonë*

Kriteret e suksesit:

- *Shpjego ç’ është seksualiteti dhe të drejtat seksuale*
- *Përshkruaj ligjet dhe rregulloret për të drejtat seksuale te njeriu*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri “Biologjia 7” laptop, projektor

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

*Gjuhë dhe komunikim, Tik, Kimi, Art Figurativ***PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

IMAGJINATË E DREJTUAR,

Mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve të qëndrojnë në heshtje dhe të mendojnë rreth të drejtave seksuale. U kërkohet të qëndrojnë kështu për rreth 2 minuta. Mësimdhënësi/ja drejton pyetjet: Si janë rregulluar të drejtat seksuale te ne? Lihen nxënësit të lirë të thonë atë çka mendojnë, pa ndërhyrë apo komentuar.

DRTA

Nxënësit lexojnë titullin dhe japin mendime e parashikime për përmbajtjen e paragrafit të parë (ç' është seksualiteti?), duke i argumentuar ato. Pasi lexojnë paragrafin e parë, ata krahasojnë përmbajtjen e tij me parashikimin e tyre. Vazhdohet kështu me paragrafin e dytë (e drejta për seksualitetin) dhe vazhdohet me gjithë tekstin. Mësimdhënësi/ja kujdeset për të sqaruar konceptet kryesore gjatë leximit me ndalesa. Diskutohet rreth informacionit të marrë në tekst dhe informacioneve të sjella nga vetë nxënësit.

SHKRIM I SHPEJTË

Në 5 minutat e fundit të orës, nxënësit do të shkruajnë shumë shkurt dhe shumë shpejt në lidhje me temën "Si janë të mbrojtura të drejtat seksuale në vendin tonë". Në këtë shkrim nxënësit do të përmbledhin mendimet në lidhje me temën dhe informacionin që morën. Disa nxënës lexojnë shkrimet e tyre. Mësimdhënësi/ja do të përqendrohet në idetë e hedhura në letër, e jo në paraqitjen e shkrimit (mënyrën si po e shkruajnë: me gabime apo me shkrim të parregullt). Jepet një fjali e pambaruar si temë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informate kthyese, vlerësim i ndersjelltë)

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hulumtoni në internet për të drejtat seksuale, ligjet dhe rregulloret

REFLEKTIMI PËR ORË MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: III Klasa: VII

Tema (nga– plani tremujor):

Shumimi te shtazët

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani tremujor):

Zbaton fjalët dhe përkufizimet kryesore në procesin e një cikli jetësor. - Hulumton dhe përshkruan format e shumimit te shtazët. - Hulumton dhe përshkruan ngjashmëritë dhe dallimet gjatë procesit të shumimit tek organizmat e ndryshëm. Hulumton fazat kryesore të zhvillimit embrional tek ujëtokësorët (në shembullin e bretkosës) dhe te shpendët (në shembullin e zogut të pulës). - Vlerëson rolin e shumimit të shtazëve në zhvillimin e botës së gjallë.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I- 6. *Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.*

II- 7. *Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.*

III- 5. *Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: ***Riprodhimi te shtazët***

Fjalët kyçe: *Riprodhimi te shtazët, riprodhimi joseksual, riprodhimi seksual, hermafroditë*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

- *Shpjegon format e shumimit të shtazëve*
- *Dallon shumimin e pakurizorëve dhe kurizorëve*
- *Përshkruan fazat kryesore të zhvillimit embrional tek ujëtokësorët (në shembullin e bretkosës)*

Kriteret e suksesit:

- *Përshkruaj riprodhimin (shumimin) joseksual dhe seksual te shtazët*
- *Shpjego mënyrën e shumimit te pakurizorët dhe kurizorët*
- *Sqaro fazat kryesore të zhvillimit embrional të bretkosës*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri “Biologjia 7“ llaptop, projektor

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Tik, Kimi, Art Figurativ

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

IMAGJINATË E DREJTUAR,

Mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve të qëndrojnë në heshtje dhe të mendojnë për riprodhimin e shtazëve. U kërkohet të qëndrojnë kështu për rreth 2 min. Mësimdhënësi/ja drejton pyetjet: Si riprodhohen shtazët? Lihen nxënësit të lirë të thonë atë çka mendojnë, pa ndërhyrë apo komentuar.

DITARI DY PJSËSH

Mësimdhënësi/ja organizon në dyshe grupet e punës. Udhëzon nxënësit se çfarë duhet të lexojnë duke mbajtur shënime dhe të interpretojnë duke plotësuar modelin e ditarit dy pjesësh, si në tabelë. Në njërën anë do të shkruajnë koceptet kryesore, e përkrah saj do të sqarojnë këto koncepte me fjali të shkurtëra dhe kuptim plot.

Shembull:

Konceptet	Sqarimet
Riprodhimi i pakurizorëve	
Riprodhimi i insekteve	
Riprodhimi i lëkurëgjemborëve	
Riprodhimi i peshqëve	
Riprodhimi i ujtokësorëve	
Riprodhimi i zvarranikëve	

RRJETI I DISKUTIMIT

Pasi nxënësit të kenë plotësuar ditarin dy pjesësh, fton ata për diskutim lidhur me sqarimet e koncepteve. Fillimisht fton nxënësit që janë më të tërhekur që të japin mendimet e tyre, pastaj vazhdon me diskutimin , nëse ndonjë sqarim nuk është interpretuar saktë nga nxënësit, atëherë sqarimet përkatëse i jep mësimdhënësi/ja.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informate kthyese, vlerësim i ndersjelltë)

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hulumtoni në internet për riprodhimin e ketyre kategorive shtazore qe mesuat sot

REFLEKTIMI PËR ORË MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: III Klasa: VII

Tema (nga– plani tremujor):

Shumimi te shtazët

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani tremujor):

Hulumton dhe përshkruan format e shumimit te shtazët. - Hulumton dhe përshkruan ngjashmëritë dhe dallimet gjatë procesit të shumimit tek organizmat e ndryshëm. Hulumton fazat kryesore të zhvillimit embrional tek ujëtokësorët (në shembullin e bretkosës) dhe te shpendët (në shembullin e zogut të pulës). - Vlerëson rolin e shumimit të shtazëve në zhvillimin e botës së gjallë.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I 2 Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.

II- 7 Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike

III 3 Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: ***Riprodhimi te shpendët dhe gjitarët***

Fjalët kyçe: *Demi, lopa, testikuj, skrotum, epididimis, uretra, gypi farëpërçues, vezikula seminale, gjëndra e prostatës, penisi, vezore, infundibulum, gypi vezëpërçuesi, mitër*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

- Përshkruan se si shpendët riprodhohen dhe kujdesen për të rinjtë e tyre
- Hulumton fazat kryesore të zhvillimit embrional te shpendët (në shembullin e zogut të pulës)
- Identifikon organet riprodhuese të shpendëve
- Përshkruan riprodhimin te gjitarët placental
- Identifikon organet e riprodhimit te demi dhe lopa

Kriteret e suksesit:

- Shpjego mënyrën e riprodhimit te shpendët dhe kujdesin për të rinjtë e tyre
- Analizo fazat kryesore të zhvillimit embrional te zogu i pulës
- Emërto dhe përshkruaj organet riprodhuese të shpendëve
- Analizo riprodhimin te gjitarët placental
- Emërto dhe përshkruaj organet e riprodhimit te demi dhe lopa

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri “Biologjia 7“ laptop, projektor

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Tik, Kimi, Art Figurativ

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

STUHI MENDIMESH

Në pjesën e parë nxësim pyetje të nxënësve rreth riprodhimit të shpendëve dhe gjitarëve placentalë: 1. Përshkruaj ndërtimin e vesës së pulës 2. Krahaso ndërtimin e organeve riprodhuese ndërmjet demit dhe lopës 3. Shpjego ku qëndron dallimi i riprodhimit të shpendëve dhe gjitarëve. Përgjigjet shënohen në tabelë.

LEXIM I DREJTUAR

Lexohet titulli “Riprodhimi të shpendëve” (paragrafi i parë). Nxënësve japin parashikimin e tyre për përmbajtjen e paragrafit. Pastaj lexohet paragrafi për organet riprodhuese të gjelrit dhe pulës si dhe mënyra e riprodhimit dhe bëhet krahasimi i informacionit me atë që parashikuan ata. Në këtë moment mësimdhënësi/ja sqaron koncepte të pyetjeve që mund t’u lindin nxënësve. Kështu vazhdohet dhe me paragrafët e tjerë me nëntitujt: “Riprodhimi të shtazëve”, “Organet e riprodhimit të demit dhe lopës”.

RRJETI I DISKUTIMIT

Pastaj mësimdhënësi/ja, fton nxënësve për diskutim lidhur me njësinë mësimore. Fillimisht fton nxënësve që janë më të tërhekur që të japin mendimet e tyre, pastaj vazhdon me diskutimin, nëse ndonjë sqarim nuk është interpretuar saktë nga nxënësve, atëherë sqarimet përkatëse i jep mësimdhënësi/ja.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informate kthyes, vlerësim i ndersjelltë)

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hulumtoni në internet për riprodhimin e ktyre kategorive shtazore që mësuat sot.

REFLEKTIMI PËR ORË MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: III Klasa: VII

Tema (nga– plani tremujor):

Shumimi te bimët

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani tremujor):

Hulumton dhe përshkruan format e shumimit te bimët. Hulumton dhe përshkruan ngjashmëritë dhe dallimet gjatë procesit të shumimit tek grupet bimore.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I 2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.**III 3.** Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet...**IV- 7.** Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.). për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

*Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.**Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.***ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**Njëësia mësimore: ***Riprodhimi i seksual i bimëve***Fjalët kyçe: *Rrënjët, kërcelli, gjethi, lulja, shumimi seksual, pjalmimi, pllenimi*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

- *Hulumton dhe përshkruan format e shumimit te bimët*
- *Shpjegon shumimin seksual të bimëve*

Kriteret e suksesit:

- *Trego mënyrën e formimit të bimëve të reja*
- *Analizo shumimin seksual të bimëve*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri “Biologjia 7“ llaptop, projektor

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

*Gjuhë dhe komunikim, Tik, Kimi, Art Figurativ***PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

STUHI MENDIMESH

Në pjesën e parë mësimdhënësi pyetje nxënësit rreth riprodhimit seksual të bimëve. Mendimet e tyre i shkruan në tabelë, duke mos i pohuar apo mohuar ato.

DITARI DY PJESËSH

Mësimdhënësi/ja organizon në dyshe grupet e punës. Udhëzon nxënësit se çfarë duhet të lexojnë duke mbajtur shënime dhe të interpretojnë duke plotësuar modelin e ditarit dy pjesësh, si në tabelë. Në njërën anë do të shkruajnë koceptet kryesore e përkrah saj do të sqarojnë këto koncepte me fjali të shkurta dhe kuptim plota.

Shembull:



Konceptet	Sqarimet
Si formohen bimët e reja	
Lulja	
Organet seksuale të lules	
Pjalmimi	
Llojet e pjalmimit	


RRJETI I DISKUTIMIT

Pasi nxënësit të kenë plotësuar ditarin dy pjesësh, fton ata për diskutim lidhur me sqarimet e koncepteve. Fillimisht fton nxënësit që janë më të tërhekur që të japin mendimet e tyre, pastaj vazhdon me diskutimin, nëse ndonjë sqarim nuk është interpretuar saktë nga nxënësit, atëherë sqarimet përkatëse i jep mësimdhënësi/ja.

Dhe mësimdhënësi-ja gjatë shpjegimit shfaqë në ekran fotografi për të cilat tregojnë p.sh., ndërtimin e lules, pjalmimin dhe llojet e tij etj.

Si p.sh.:





1. EKSPERIMENT

(këto eksperimente realizohen në orën e përsëritjes së njësisë mësimore ose gjatë ushtrimeve)

a) Vrojto me mikroskop kokrrat e polenit nga dy lloje të bimëve, p.sh., nga molla dhe trëndafili dhe realizoni një prerje tërthore të lules. Për eksperiment janë të nevojshme: nga një lule prej secilës bimë, xhami i objektit, xhami mbulues, një pikatore, pinceta, gjilpëra dhe mikroskopi .

Përshkrimi i eksperimentit:

Nga lulet e mollës dhe qershisë merrni nga një apo më shumë thek dhe shkundni secilin në xhama të veçantë të objektit. Vendosni nga një pikë ujë dhe mbi të xhamin mbulues. Pasi t'i vrottoni nën mikroskop, vizatoni format e kokrrave të polenit në katrorët poshtë. Në katror shëno emrin e bimës, të cilës i përkasin dhe përshkruani format e kokrrave të polenit:

2. EKSPERIMENT

Analiza e ndërtimit të një luleje qershie Mjetet që ju duhen për analizën e një luleje qershie janë: përveç lules, duhen një palë pinceta dhe një letër apo pllakë me ngjyrë të zezë. Letra apo pllaka e zezë vendoset mbi tavolinë. Përshkrimi i eksperimentit: Përdorni pincetën për të këputur lehtë petalet, pastaj sepalet, thekët dhe, më në fund pistilin! Vendosni pjesët e luleve në letër apo pllakë si në figurën në fletore pune. Ju tani keni një pamje të lulëzimit të qershisë. Nga kjo mund të shihni ndërtimin dhe numrin e pjesëve të luleve. Nëse i keni vendosur pjesët e luleve në mënyrë të duhur, është e thjeshtë që në formë të vizatimit të fitohet një plan luleje.

3. EKSPERIMENT

Si ndodh pllenimi (fekondimi)? Një eksperiment i thjeshtë: Lëkundni bisqet e një dege të pishës apo të ndonjë bime tjetër menjëherë pas çeljes së luleve. Nga lëkundja kokrrat e polenit nuk mund të rrinë më në lulet e atyre bisqeve. Rezulton se asnjë frutë nuk mund të zhvillohet nga këto lule. Te lulet e degëve të tjera që nuk janë prekur kokrrat e polenit fillojnë të mbijnë, dhe kemi zhvillimin e frutave.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informate kthyesë, vlerësim i ndersjelltë)

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Merrni një lule në shtëpi dhe paraqiteni atë në formë diagrami

REFLEKTIMI PËR ORË MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: III Klasa: VII

Tema (nga- plani tremujor):

Shumimi te bimët

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani tremujor):

Vlerëson rolin e shumimit të bimëve në zhvillimin e botës së gjallë.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I 3. Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.

III- 3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

III 5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: ***Lulet i japin farat dhe frutat***

Fjalët kyçe: *Fara, fruta, përhapja e bimëve, mbirja e farës, rritja e bimës*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

- *Vlerëson rolin e shumimit të bimëve duke përshkruar formimin dhe ndërtimin e farës*
- *Identifikon pjesën e lules nga e cila formohet fruta*
- *Tregon mënyrat e përhapjes së bimëve*
- *Shpjegon mbirjen e farës dhe rritjen e bimës*

Kriteret e suksesit:

- *Analizo formimin e farës dhe ndërtimin e saj*
- *Përcakto pjesën e lules nga e cila formohet fruta dhe trego llojet e frutave*
- *Shpjego mënyrat e përhapjes së bimëve*
- *Përshkruaj mbirjen e farës dhe rritjen e bimës*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri “Biologjia 7“ llaptop, projektor


Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Tik, Kimi, Art Figurativ

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

IMAXHINATË E DREJTUAR

Mësimdhënësi-ja shfaqë në ekran disa fotografi të frutave të ndryshme, dhe farave, pastaj pyet nxënësit se çfarë po kuptojnë spo shohin fotografitë. Përgjigjet e nxënësve i merr pa i mohuar apo pohuar ato.



DITARI DY PJESËSH

Mësimdhënësi-ja organizon në dyshë grupet e punës. Udhëzon nxënësit se çfarë duhet të lexojnë duke mbajtur shënime dhe të interpretojnë duke plotësuar modelin e ditarit dy pjesësh, si në tabelë. Në njërën anë do të shkruajnë koceptet kryesore, e përkrah saj do të sqarojnë këto koncepte me fjali të shkurta dhe kuptim plota.

Shembull:

Konceptet	Sqarimet
Fara	
Fruta	
Përhapja me anë të erës	Përhapja me anë të erës – frutat, të cilat janë të lehta dhe kanë shtojca të ndryshme, përhapen nga era, të tilla janë: farat e panjës, plepit, shelgut, pambukut etj.
Përhapja me anë të shtazëve	Përhapja me anë të erës – frutat, të cilat janë të lehta dhe kanë shtojca të ndryshme, përhapen nga era, të tilla janë: farat e panjës, plepit, shelgut, pambukut etj.
Përhapja me anë të ujit	Përhapja me anë të ujit - kjo ndodh me bimët që rriten pranë ujit, farat përmbajnë hapësira të mbushura me ajër që i ndihmojnë ato të notojnë dhe të mos përmblyten nga rrymimet e ujit.
Vetëpërhapja	Vetëpërhapja - ndodh kur muret e frutave të disa bimëve thahen dhe shpërthejnë. Çarja e tyre shpërthyesë në flegra i shpërndan farat larg nga vendi ku gjendet bima, p.sh., bimët që kanë fruta kapsullë.

RRJETI I DISKUTIMIT

Pasi nxënësit të kenë plotësuar ditarin dy pjesësh, fton ata për diskutim lidhur me sqarimet e koncepteve. Fillimisht fton nxënësit që janë më të tërhekur që të japin mendimet e tyre, pastaj vazhdon me diskutimin , nëse ndonjë sqarim nuk është interpretuar sakt nga nxënësit, atëherë sqarimet përkatëse i jep mësimdhënësi-ja.

EKSPERIMENT

(munt ta beni eksperimentin ne oren e ushtrimeve)

Përcaktimi i pjesëve të farës. Mjetet që ju duhen për eksperiment janë: një enë me ujë dhe disa fara të fasules. Përshkrimi i eksperimentit: Farat e fasules vendosen në enën me ujë dhe qëndrojnë disa ditë. Pasi të vëreni se farat kanë filluar të ndryshojnë, ju praktikisht përcaktoni pjesët e atyre farave dhe analizoni ndryshimet e tjera në to, duke i komentuar së bashku me mësimdhënësin/en.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie (informate kthyses, vlerësim i ndersjelltë)

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hulumtim në internet për mënyrat e përhapjes së bimëve dhe mbirjes së tyre.

REFLEKTIMI PËR ORË MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: III Klasa: VII

Tema (nga– plani tremujor):

Shumimi te bimët

Rezultati i të nxënit të temës (nga plani tremujor):

- Hulumton dhe përshkruan format e shumimit te bimët.
- Hulumton dhe të përshkruan ngjashmëritë dhe dallimet gjatë procesit të shumimit tek grupet bimore.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I 3. Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim

III- 3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet

III 5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.

Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Shumimi joseksual i bimëve**

Fjalët kyçe: Riprodhimi joseksual, rizomët, zhardhokët, bulbat, stolonet, shartimi, klonimi

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

- Hulumton dhe përshkruan riprodhimin joseksual te bimët
- Identifikon format e riprodhimit joseksual te bimët

Kriteret e suksesit:

- Trego si ndodh riprodhimi joseksual te bimët
- Shpjego metodat e riprodhimit artificial te bimët

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Libri “Biologjia 7” lllaptop, projektor

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Tik, Kimi, Art Figurativ

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

MENDO, PUNO, THUAJE

Mësimdhënësi/ja krijon grupe dhe jepen tema të kundërta, njërit grup për riprodhimin natyror joseksual, ndërsa grupit tjetër për riprodhimin artificial dhe të dy grupet i lexojnë përgjigjet e tyre.

RUAJE FJALËN E FUNDIT PËR MUA

Në fazën e dytë mësimin e ndajmë në grupe, secili grup e lexon një paragraf, që pas leximit të reflektojnë dhe mendohen, krijon mundësi që diskutimi të bëhet me krejt klasën. Nxënësit gjatë leximit duhet të gjejnë një pjesë interesante rreth riprodhimit joseksual të bimëve. Ata në fleta A4 përmendin disa nga metodat e riprodhimit artificial, të cilat i komentojnë nxënësit dhe në fund hapet debati.

KLLASTER

Pasi të përfundojë pjesa e shtjellimit të temës mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve të mbyllin librat dhe me informacionet e fituara të ndërtojnë një kllaster të cilin pastaj e realizojnë në tabelë me ndihmen e disa nxënësve në formë përmbledhje. (përafërsisht kështu).

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime)

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Plotësoni fletore pune

REFLEKTIMI PËR ORË MËSIMORE

TEST VLERËSUES

1. Cili është roli i qelizave të gjakut?

- a) Prodhimi i hormoneve dhe enzimave
- b) Shumimi i organizmit
- c) Mbrojnë trupin nga agjentet e huaj, si dhe të transportojnë gazet dhe ushqimin
- d) Prodhimi i hormoneve dhe enzimave.

2. Trego rolin e Indit lidhorë

- a) Mundëson lëvizjen e trupit
- b) Mbron trupin dhe organet e brendshme
- c) Ndërton trurin, palcën kurrizore dhe nervat
- d) Mbron organizmin, shërben për mbështetje transporton gazet.

3. Lidhi me vija shprehjet e anës së majt me karakteristikat e shënuara në anën e djatht.

Qelizat epiteliale-	- krijojnë impulset nervore.
Qelizat yndyrore-	- mundësojnë lëvizjen.
Qelizat e gjakut-	- depozitojnë minerale.
Qelizat sekretuese-	- mundësojnë lëvizjen.
Qelizat nervore-	- mbulojnë dhe mbrojnë qelizat.
Qelizat e kërcit-	- prodhim të hormoneve dhe enzimave.
Qelizat muskulore-	- depozitojnë yndyrëra.
Qelizat seksuale-	- mundësojnë shumimin e organizmit.
Qelizat eshtërore-	- mbrojnë trupin nga agjentet e huaj dhe të transportojnë gazet dhe ushqimin.

4. Në cilin sistem bënë pjesë sistemi hormonal-endokrin?

- a) Metabolizm dhe transport
- b) Komunikim
- c) Mbrojtje dhe lëvizje
- d) Riprodhim.

5. Pse qelizat e bardha të gjakut quhen "policia shëndetësore" e trupit?

- a) Mundësojnë mpiksjen e gjakut dhe mbyllin plagët e hapura kur ne lëndohemi
- b) Transportojnë oksigjenin, të cilin e marrin në mushkëri, deri në qeliza të tjera të trupit, si dhe dioksidin e karbonit nga qelizat deri te mushkëritë
- c) Mundësojnë luftimin e mikroorganizmave dhe trupave të huaj që e sulmojnë organizmin
- d) Bartin ujin dhe lëndët e tretura ushqyese deri te qelizat dhe indet.

6. Shëno në tabelë emërtimin e qelizave të gjakut, vendin ku formohen, sasinë dhe funksionet e tyre.

Qelizat e gjakut	Vendi i formimit	Sasia për mm ³	Funksionet

7. Shëno për secilin grup të gjakut kujt i japin dhe nga kush marrin gjak

- a) Njerëzit me *Grupin A* të gjakut marrin gjakun prej.....dhe i japin.....
- b) Njerëzit me *Grupin B* të gjakut marrin gjakun prej.....dhe i japin.....
- c) Njerëzit me *Grupin AB* të gjakut marrin gjakun prej.....dhe i japin.....
- d) Njerëzit me *Grupin O* të gjakut marrin gjakun prej.....dhe i japin.....

8. Emërto tre llojet e muskujve dhe përshkruaj shkurtimisht si funksionojnë ata.

Tre llojet e muskujve**Funksionimi**

9. Emërto pjesët e sistemit zorror dhe rolin e tyre në tretjen e ushqimit.

1		
2		
3		

10. Shëno: Sistemi nervor ndërtohet nga _____ dhe _____ (_____), si dhe nervat që degëzohen në trup (_____).

Vlerësimi

Pikët	0 – 39	40 – 59	60 - 79	80 - 89	90 - 100
Nota	1	2	3	4	5